




**Kërkesë e lartë për naftë pa taksa nga fermerët, AZHBR nis shpërndarjen e kartave**

Faqe 2



**Krifca në Panairin e Bujqësisë në Lushnjë: Faktor në rajon si origjinë e eksporteve të prodhimeve bujqësore**

Faqe 2



**AKU: Kontrollat për sigurinë ushqimore sipas BE-së, garantojmë konsumatorin nga ferma në tavolinë**

Faqe 5



# AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,  
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit maj 2023

**Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 461**  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

# RIVITALIZIMI I SHKOLLËS BUJQËSORE "RAKIP KRYEZIU"

## SFIDAT E ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL NË SHQIPËRI PERSPEKTIVA E BUJQËSISË

*Arsimi dhe formimi profesional bujqësor në shkollën e mesme bujqësore "Rakip Kryeziu" Fier, ku ndërthuret trajnimi teorik me praktikën në punë, është alternativa më e mirë për rritjen e punësimit të rinjve në këtë sektor, që konsiderohet me potencial të lartë dhe rëndësi të veçantë për ekonominë e vendit*

### RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

#### Çfarë tregoi panairi "Ditët e Bujqësisë 2023"

RisiAlbania prezantohet në Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë në Lushnjë

Nga: Andon Rrapokushi  
Anëtar i NTWG Albania



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



### PORTRET



**Dy fjalë për veprën letrare të Shefqet Mekos, shkruan ish-ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit Luftër Xhuveli**

Faqe 10

### IPARD III, MBZHR: Fituam besimin e BE-së, shtohen sektorët që do të mbështeten

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca deklaroi se IPARD II, programi i Bashkimit Evropian për mbështetjen e subjekteve në zinxhirin nga ferma, deri tek agropërpunimi dhe zhvillimi i zonave...



Faqe 3

### BUJQËSI

**Fermerët e Lushnjës, prodhimi i serrave i kontraktuar për shitje**



Faqe 4

### GRUAJA NË SIPËRMARRJE

**Nga tradita te fuqizimi - gratë artizane mësojnë aftësi të reja në qendrën e sapokrijuar artizanale në Tiranë**

Faqe 10

### KËNDI I EKSPERTIT

- Tokat e kripura shtrirja dhe rrugët e përmirësimit të tyre Fq.11
- Këshilla për fermerët që mbarështojnë bagëti të imta Fq.12
- Kafshët shtëpiake dhe kafshët shoqëruese të fermës Fq.13

## RISI ALBANIA

## BUJQËSI

## Çfarë tregoi panairi “Ditët e Bujqësisë 2023”

RisiAlbania prezantohet në Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë në Lushnjë

Nga: Andon Rrapokushi  
Anëtar i NTWG Albania

Panairi Ditët e Bujqësisë 2023 që u zhvillua nga 27-29 prill në Lushnjë, ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme të bujqësisë për këtë vit, i cili pasoi atë të një viti më parë të zhvilluar në maj 2022, me të njëjtin organizator kryesor, Iceberg Exhibition.

Përzgjedhja e Bashkisë Lushnje, pjesëmarrja serioze e një numri relativisht të lartë të agrobizneseve, institucioneve financiare dhe bankave që i mbështesin ato, e projekteve të mëdha si Food Safety Project financuar nga BE, projekti Helvetas/RisiAlbania, pjesëmarrja e organizatave dhe donatorëve prestigjiozë si GIZ, Vodafone Albania, e ekspertëve vendas dhe të huaj nga vendet Balltike, nga Zvicra, Spanja etj tregojnë vlerat e këtij eventi të rëndësishëm. Në krahasim me vitin e kaluar, kishte një rritje të subjekteve pjesëmarrëse nga 60 në rreth 80 të tilla.

Pavarësisht se peshorja anon nga vlerat që solli panairi i Lushnjes, disa probleme dhe mangësi të kësaj ngjarjeje me karakter kombëtar në fushën e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit, teknologjisë dhe mekanizimit bujqësor, duhen vënë në dukje dhe të trajtohen në mënyrë konstruktive për tu marrë në konsideratë për përmirësimin e mëtejshëm të organizimeve të eventeve me përmasa të tilla.

**Axhenda e aktiviteteve kishte dy pamje:**

Së pari, ishte e mirëpërzgjedhur për nga tematika e larmishme, ku në panele të ndryshme, spikatën temat për standartet ndërkombëtaare të cilësisë së produkteve (trajtuar nga Grupi Teknik GLOBALG.A.P. NTWG Albania), temat për teknologjitë inovative në agrobiznes (trajtuar nga disa subjekte, Vodafone, Helius Solutions, Fed Invest – ABA online, Austria Praemix, Teknologjia Spanjolle në sera), temat për kulturën e biznesit në tregjet e zhvilluara të eksporteve (organizuar nga Gateway & Partners, ku u shpalos eksperiencia e kulturës së tregjeve ushqimore të Letonisë, Lituonisë dhe Estonisë), shërbimet financiare dhe partnershipi me fermerët (trajtuar nga banka NOA, si edhe nga institucione të tjera si OTP Bank, Credins, Fondi BESA etj), kontrolli biologjik në sera për zero pesticide në produkte (organizuar nga partneri gold GIZ), ushqyerja e bimëve dhe plehëruesit kimikë/organikë (organizuar nga AGRIMATCO), etj.

Së dyti, duke lënë mënjanë tematikën e larmishme dhe të goditur të axhendës, ajo që binte në sy ishte fakti që ajo përmbante një program tepër të ngjeshur, sidomos gjatë dy ditëve të para të panairit. Çdo orë e zënë me workshop-e, prezantime e forume, dhe kjo



frekuencë e lartë nuk rezultoi shumë efektive, përderisa ndikoi në rënien graduale të numrit dhe interesit të pjesëmarrësve, shtu edhe hapësirën e hapur ku u zhvilluan workshop-et, e cila ndikoi në cilësinë e dëgjimit.

Duke bërë një krahasim me panairin e vitit të kaluar, që u zhvillua në maj 2022, ndryshimi është se vjet të gjitha temat u trajtuan në kuadër të një forumi dhe në një mjedis të mbyllur në Teatrin Vaçe Zela në Lushnjë, ku njerëzit dhe audiencat përkatëse ishin të mirëinformuar për tematikën qysh përpara zhvillimit të panairit nëpërmjet publikimit që ju bë jo vetëm nga organizatori, por edhe nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar dhe publikimit të gjerë të atij forumi në gazetën Agrobiznesi. Kështu edhe target grupet u informuan më mirë sipas temave të interesit përkatës.

Një nga pikat e rëndësishme të panairit të sivjetshëm të Lushnjes që duhet nënvizuar, është se ai tregoi domosdoshmërinë e kualifikimit dhe të trajnimeve në të gjitha nivelet e sektorit të bujqësisë, të agroturizmit, blegtorisë dhe të sigurisë ushqimore, si në nivel qendror (të organizimeve publike të lidhura me industrinë e sigurinë ushqimore dhe kërkimet shkencore), ashtu edhe në nivel lokal, në sektorin privat, në kompanitë eksportuese e deri në nivel ferme.

Shembulli pozitiv i ciklit të trajnimeve të tetorit 2022 mbështetur nga Ministria e Bujqësisë dhe zbatuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës tregon mënyrën efikase dhe profesionale të trajnimit dhe kualifikimit të punonjësve publikë por edhe privatë, të cilët ishin ftuar, një shembull i cili duhet ndjekur edhe nga projekte të tjera në fushën e trajnimeve, siç është Projekti

i Sigurisë Ushqimore, financuar nga BE, pjesëmarrës në Panairin e Bujqësisë të këtij viti, një projekt i rëndësishëm, me mundësi të mëdha për trajnimin dhe kualifikimin e zyrtarëve publikë në sektorin e fruta-perimeve, qumështit dhe mishit, siç dhe me të drejtë

klamohet në LinkedIn.

Por në Panairin e Lushnjes u sugjerua që rrethi i pjesëmarrjes të rritet, të dilet nga guacka e “high representatives participated”, të ftohen të marrin pjesë në këto cikle trajnimesh edhe përfaqësues të subjekteve private bazuar në profilin e tyre, të pikave të grumbullimit të fruta-perimeve, të grumbullimit dhe përpunimit të qumështit dhe të mishit, të cilët janë ngushtësisht të lidhur me çështje të higjienës dhe sigurisë ushqimore çdo ditë.

Pikat e mëdha të grumbullimit të produkteve e kanë të domosdoshme kualifikimin e specializuar të personelit të tyre në fushën e standarteve të cilësisë dhe duhet ta marrin më seriozisht. Ato duhet të krijojnë një strukturë të veçantë, një grup të sigurisë ushqimore ose njësi të menaxhimit të cilësisë, i domosdoshëm kur flasim për standarte të larta dhe produkte të pastra e të shëndetshme. Trajnimet, kualifikimet, njohuritë e reja dhe zbatimi korrekt i procedurave të standarteve do të na bëjnë më konkures në tregjet rajonale dhe globale.

Megjithëse në panelet e panairit u fol për standarte cilësie dhe gjëra të rëndësishme për pikat që grumbullojnë dhe eksportojnë fruta dhe perime, dhe megjithëse në panair morën pjesë dhe dhanë përvojën e tyre edhe ekspertë të huaj për eksportet nga vende të zhvilluara, fatkeqësisht nuk mund të thuhet asgjë për paraqitjen e kompanive shqiptare të eksporteve të këtyre produkteve në panair.

Mospjesëmarrja e tyre në Ditët e Bujqësisë 2023, aq më tepër që ky event u zhvillua pikërisht në Lushnjë, ku shumica e ketyre agrobizneseve kanë qendrat e tyre, si edhe në Berat dhe Divjakë,

(Vijon në faqen 13)

## Kërkesë e lartë për naftë pa taksa nga fermerët, AZHBR nis shpërndarjen e kartave

Mbi 68 mijë fermerë i janë përgjigjur thirrjes së Skemës Kombëtare të mbështetjes në Bujqësi 2023, ndërkohë që për t’iu përgjigjur interesit të lartë të fermerëve për naftë pa taksa, ka nisur procesi i shpërndarjes së kartave.

Mbështetja me naftë pa taksa ka rezultuar edhe masa më e kërkuar nga fermerët të cilët aplikuan për mbështetje për rritjen e sipërfaqeve të mbjella, ndërsa janë shtuar proceset e mekanizuara në Bujqësi.

Kërkesa ka qenë e lartë, me 54 mijë fermerë që aplikuan për këtë masë mbështetëse.

Përballë kësaj kërkesë ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, thotë se të parët që do të marrin mbështetje do jenë pikërisht këta bujq, me qëllimin kryesor që fermerit shqiptar t’i ulen kostot e prodhimit bujqësor.

“Kemi filluar me printimin e kartave të naftës, llogariten

rreth 34 mijë karta fermeri të cilat do të shpërndahen. Nisim me naftën për t’i ardhur në ndihmë fermerëve, për uljen e kostove në punimet e mekanizuara në bujqësi. E kemi tenderuar që në momentin e parë që është çelur buxheti dhe ka nisur praktikisht shpërndarja e kartave për naftën falas tek fermerët, duke i ardhur në ndihmë bujqëve që të vijojnë punën me kosto më të ulta”, u shpreh Krifca në një intervistë televizive.

Krifca shpjegoi se, skemat e subvencionimit luajnë dhe një rol tjetër të rëndësishëm në bujqësinë shqiptare, në nxitjen e formalizimit që për konsumatorin, kthehet në siguri ushqimore, ndërsa për fermerët, NIPT-i, i hap rrugën në tregjet e reja ndërkombëtare.

“Masat tona po shkojnë edhe në formalizimin e bujqësisë. Sepse duhet ta theksojmë se pa incentivën e subvencioneve

përmes skemave mbështetëse, shohim një vështirësi që fermerët të formalizohen dhe të hyjnë në të gjithë zinxhirin tregtar të vlerës ku bujqësia shqiptare aktualisht po shkon” u shpreh Krifca.

“Kemi shifra shumë të mira të eksporteve të publikuara edhe nga INSTAT-i”, tha ministria.

Sipas saj, për 3 mujorin e parë të vitit 2023 eksportet janë rritur me 17% në sasi, por paralelisht rritje shënohet edhe në vlerën e tyre. Kjo për faktin se fermerët po prodhojnë me cilësi gjithë e më të lartë dhe eksportet shqiptare po shkojnë tashmë në tregje gjithënjë e më shumë të sofistikuar, që kanë edhe çmime më të larta.

Për të frenuar tkurrjen në blegtori këtë vit të gjithë blegtorët dhe bletarët do të mbështeten financiarisht pavarësisht numrit në renditjen e aplikimit.

## Krifca në Panairin e Bujqësisë në Lushnjë: Faktor në rajon si origjinë e eksporteve të prodhimeve bujqësore

“Ky do të jetë viti i bujqësisë, në drejtim të mbështetjes së shtuar ndaj fermerëve dhe rezultateve pozitive që regjistron ky sektor”.

Kështu deklaroi ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca në Panairin

kaluar, ku patëm 500 milionë dollarë eksporte bujqësore. Ky tremujor është rritur me 7,6 % në sasi dhe mbi 18 % në vlerë”, tha Krifca.

Në fund të kësaj prarëve ministria bëri të ditur se, agropërpunuesit do të kenë

rrisë sasinë dhe cilësinë e prodhimeve “Made in Albania”.

“I kemi kërkuar Komisionit Evropian që pjesë e programit IPARD III të mund të përfshihet dhe ndërtimi i infrastrukturës, i ambienteve të grumbullimit, të pikave të grumbullimit apo siloseve për grurin dhe misrin. Kemi marrë prej tyre miratimin, në mënyrë që subjektet private, apo investitorë të ndryshëm të mund të investojnë për këtë nevojë që tregu aktualisht ka, meqenëse nuk e kemi këtë lloj infrastrukture, pra dëgjojmë njëri-tjetrin dhe adresojmë problematikat për t’i dhënë zgjidhje”, u shpreh ministria.

Krifca tha se “Shqipëria tashmë është bërë faktor në rajon si origjinë e eksporteve të prodhimeve bujqësore që ushqejnë konsumatorin evropian”.

Ministria dha lajmin se kësaj herë fermerët fondet e skemës kombëtare do t’i marrin më shpejt se kurrë. Të hënën mbi 2000 fermerë duhet të bëhen gati të tërheqin naftën falas.

“Duke filluar nga java tjetër jemi gati të shpërndajmë subvencionet për ‘Skemën Kombëtare 2023’. Janë 2000 karta naftë të printuara për Skemën e Naftës, kështu do të vijojmë deri sa të shkojmë në fund”, bëri të ditur ministria.

Nga 27-29 prill mbi 60 subjekte të ndryshme bujqësore nga vendi dhe Europa do të jenë në Lushnjë për të lidhur marrëveshje të ndryshme tregtare me synim që fermerët të rrisin sipërfaqet e të mbjellave dhe grumbulluesit të shtojnë sasinë e eksporteve bujqësore.



“

**Krifca:**

**I kemi kërkuar Komisionit Evropian që pjesë e programit IPARD III të mund të përfshihet dhe ndërtimi i infrastrukturës, i ambienteve të grumbullimit, të pikave të grumbullimit apo siloseve për grurin dhe misrin. Kemi marrë prej tyre miratimin, në mënyrë që subjektet private, apo investitorë të ndryshëm të mund të investojnë për këtë nevojë që tregu aktualisht ka, meqenëse nuk e kemi këtë lloj infrastrukture, pra dëgjojmë njëri-tjetrin dhe adresojmë problematikat për t’i dhënë zgjidhje**

Ndërkombëtar “Ditët e Bujqësisë 2023” në Lushnjë.

“Tremujori i parë i vitit është mbyllur me një shifër rekord në rritje krahasuar me vitin e

mundësi të aplikojnë në programin IPARD III, i cili do të injekttojë 146 milionë euro në bujqësinë shqiptare, me qëllimin e vetëm që fermeri ynë të

## RIVITALIZIMI I SHKOLLËS BUJQËSORE "RAKIP KRYEZIU"

## SFIDAT E ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL NË SHQIPËRI PERSPEKTIVA E BUJQËSISË

*Arsimi dhe formimi profesional bujqësor në shkollën e mesme bujqësore "Rakip Kryeziu" Fier, ku ndërthuret trajnimi teorik me praktikën në punë, është alternativa më e mirë për rritjen e punësimit të rinjve në këtë sektor, që konsiderohet me potencial të lartë dhe rëndësi të veçantë për ekonominë e vendit*

Zhvillimi i sistemit arsimor është me rëndësi për rolin vendimtar në rrugën e zhvillimit në përgjithësi dhe konkretisht për ekonominë e vendeve. Vitet e fundit Qeveria i ka dhënë një prioritet të madh sistemit arsimor dhe veçanërisht arsimin profesional, si faktor që nxit mirëqenie më të mirë. Shqipëria, si një vend i vogël dhe në zhvillim, po përballlet me një sërë sfidash në lidhje me sistemin e saj arsimor, në përgjithësi, dhe më konkretisht, në shkollat profesionale. Arsimi në përgjithësi dhe veçanërisht ai profesional lidhur me sektorin e bujqësisë është shumë i rëndësishëm veçanërisht në ditët e sotme kur Shqipëria është një vend aspirues për të qenë anëtare e plotë e Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst vëmendje të rëndësishme ka marrë rivitalizimi i shkollës së mesme profesionale bujqësore "Rakip

Kryeziu", Fier, si një ndër shkollat emblemë në fushën e bujqësisë.

Kjo shkollë profesionale luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e kandidatëve të kualifikuar, të gatshëm për të punuar, të pajisur me njohuri, aftësi dhe qëndrime pune në përputhje me nevojat e tregut. Rivitalizimi i kësaj shkolle vjen si një nevojë kombëtare për këtë periudhë ku shumë sipërmarrje, sidomos ato në zona rurale, kanë mungesa të theksuara në staf të nivelit të mesëm.

Shkolla e Mesme Bujqësore "Rakip Kryeziu" Fier, është hapur në vitin 1952, si e para shkollë e mesme në të gjithë Myzeqenë. Pas këtij viti kjo shkollë funksionoi si shkollë rajonale me drejtimet agronomi dhe zootekni. Pas vitit 1980 në shkollën tonë u shtua dhe një degë e tretë, drejtimi Veterinari. Me këto tre specialitete, me një

numër të madh nxënësish shkolla vazhdoi deri në vitin 1990-1991 duke dhënë një kontribut të paçmuar në zhvillimin e bujqësisë jo vetëm në rajon, por në të gjithë vendin. Nga viti 1992 dhe deri në vitin shkollor 1999-2000 përveç degëve Agronomi dhe Zootekni shkolla vijoi edhe me nivelet 2-vjeçare dhe 3+2 për degët: Prodhim Blegtoral dhe Agromekanizator. Në vitin 1999 krahas këtyre degëve u hap sërish specialiteti Veterinari. Në vitin 2001-2002 u hap një degë e re, specialiteti Agrobiznes me nivel 5-vjeçar.

• Në vitin 2002 u bashkua me shkollën e ndërtimit që ishte e nivelit 3-vjeçar me këto specialitete: Hidraulikë, Mobileri, Kimi Ushqimore, Konfeksione.

• Në vitin shkollor 2003-2004 u shtuan dhe degët Elektrikë, Mekanikë të nivelit 3-vjeçar, kurse në vitin shkollor 2004-

2005 dega Elektrikë e nivelit 5-vjeçar.

• Pas vitit 2009 me ndryshimet që pësoi sistemi arsimor edhe në shkollën tonë pati ndryshime, si në strukturë edhe në kurrikula.

• Vendosija e sistemit 2+1+1 (nivele) për degët Mekanike, Shërbime Mjete Transporti, Termohidraulikë, Elektrikë, Bujqësi, dhe Veterinari 4 vite (bllok) bëri që shkolla të merrte një tjetër dimension.

• Në vitin shkollor 2012-2013 hapet drejtimi Shërbime sociale dhe shëndetësore.

• Për vite me radhë shkolla ka vuajtur nga mungesa e regjistrimeve të reja, sidomos kjo në drejtimet e Bujqësisë dhe Veterinarisë. Vetëm në vitin 2014-2015 ndryshoi situata ku numri i regjistrimeve të reja për këto drejtime u trefishua. Por vit pas viti gradualisht ky numër pësoi rënie.

• Në vitin 2015-2016 hapet drejtimi Teknologji ushqimore.

Ndihma dhe mbështetja e projekteve të huaja për arsimin profesional nuk i ka munguar shkollës sonë. Ndër vite përmenden projektet: STAOS, AgriAL, SwissContact, SNV, ALVet, GIZ dhe më së fundmi PEMA PROJECT, një projekt i cili synon që deri në fund të vitit 2023 shkolla të kthehet në një qendër multifunkionale për bujqësinë në gjithë rajonin.

Ky projekt është pjesë e një marrëveshjeje të lidhur nga Qeveria e Republikës Italiane, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për realizimin e së cilës është akorduar një vlerë prej 5 milionë €.

Projekti përfaqëson një kanal operacional për transferimin e njohurive dhe aftësive në fushën e formimit profesional agroshtetëror dhe agro-mekanik, bazuar në përvojën e Institutit të Arsimit të Mesëm të Ekselencës të Rajonit Emilia-Romagna.

Duke filluar nga viti 2020, PEMA ofron projektin e Asistencës Teknike (AT) me një afat tre vjeçar "Mbështetje për Arsimin dhe Formimin Profesional përmes Inovacionit", qëllimi i të cilit është të kontribuojë në krijimin e një qendre multifunkionale ekselence në sektorin bujqësor dhe agroindustrial në qarkun e Fierit.

Shkolla sot me një infrastrukturë moderne e bashkëkohore do t'u ofrojë, veçanërisht të rinjve, një mundësi të shkëlqyer arsimimi dhe formimi profesional, gjithnjë e më afër nevojave të tregut të punës.

## IPARD III, MBZHR: Fituam besimin e BE-së, shtohen sektorët që do të mbështeten

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca deklaroi se IPARD II, programi i Bashkimit Evropian për mbështetjen e subjekteve në zinxhirin nga ferma, deri tek agropëpunimi dhe zhvillimi i zonave rurale në Shqipëri po rezultoi i suksesshëm.

Krifca mori pjesë në Mbledhjen e Komitetit të Programit IPARD, në lidhje me progresin e IPARD II dhe përgatitjen për çeljen e programit të ri IPARD III që u zhvillua në Pezë të Tiranës, në një prej bujtinave të mbështetura nga ky program.

Takimi bëri bashkë përfaqësues të lartë të DG-Agrit të Komisionit Evropian, Delegacionit të BE-së në Shqipëri, si dhe aktorë nga të gjithë sektorët e linjës dhe sipërmarrjes private.

Krifca e cilësoi këtë takim, një hap të ri dhe të rëndësishëm të bashkëpunimit dhe të bujqësisë shqiptare drejt rritjes së produktivitetit, qëndrueshmërisë, rritjes së të ardhurave, sigurisë dhe standardeve evropiane.

"Me mbështetjen e programit IPARD sipërmarrjet në Shqipëri po ndërtojnë një realitet tjetër në ekonominë e tregut, duke modernizuar ekonominë e vendit dhe zhvilluar zinxhirin bujqësor, sipas standardeve të BE-së ku duam të aderojmë", tha ministrja.

Krifca informoi drejtuesit e programit mbi ecurinë e zbatimit të IPARD II, sukseseve dhe vështirësitë e këtij programi dhe asaj që solli në bujqësinë shqiptare duke hapur perspektiva të reja.

Ministrja tha se, ka përfunduar tashmë puna përgatitore që edhe IPARD III të jetë po aq i suksesshëm, duke pasur në

fokus masa të reja mbështetëse edhe për fermerët e rinj dhe gratë që të mos braktisin zonat rurale.

"Suksesi i programit IPARD ka në themel përpjekjen titanike të kryeministrit Edi Rama, i cili vlerësoi këtë program dhe pa që rezultatet ishin reale, janë investime të prekshme, të cilat përkthehen në buxhetin e shtetit shumë e më shumë, sesa ato vlera që ne i dedikojmë këtij programi", u shpreh Krifca.

Ajo tha se qasja, orientimi i fermerëve dhe sipërmarrjeve që kanë zgjedhur të merren me një sektor të vështirë siç është bujqësia, drejt formalizimit, ekonomizimit dhe të bërit biznes sipas rregullave të BE-së, tregon se fermerët tanë, janë ata të parët që na kanë futur në BE.

Ishte pikërisht kjo bazë pozitive dhe angazhimi i qeverisë që ndikoi në vendimin e Komisionit Evropian më datë 9 mars 2022, me një buxhet grant shtesë (BE dhe qeveria shqiptare) me 146 milionë euro ose rreth 52 milionë euro, ose 55 % më shumë sesa Programi IPARD II mbështetja për bujqësinë shqiptare.

Instrumenti do të ndihmojë që të gjenerohen më shumë se 79 milionë euro investime private, të cilat do të prodhojnë vlerë të shtuar në bujqësi, blegtori, agropëpunim.

Kjo mbështetje e BE-së, së bashku me kontributet kombëtare publike dhe private, do të injektosh në total mbi 225 milionë euro investime, nga 169.9 milionë euro që janë nën Programin IPARD II) në zonat

rurale të Shqipërisë.

Ministrja e vlerësoi IPARD III si mbështetje në ndërtimin e një rruge të sigurt zhvillimi, ku bujqësia shihet e integruar si pjesë e një ekosistemi, që ofron shërbime pozitive për zonat rurale dhe përbën një gur themeli në zhvillimin gjithëpërfshirës të ekonomisë.



Krifca tha se, objektivi ambicioz i qeverisë është zhvillimi i një bujqësie të qëndrueshme, nën moton e objektivave të BE-së përsa i takon Axshtës së Gjellbër 2030, ku ne kemi angazhime serioze për rritjen e prodhimit organik.

Lajtmotiv i IPARD II ka qenë vendosmëria për t'ia dalë me zhvillimin e këtij sektori.

"Fituam besimin e Bashkimit Evropian, ndaj dhe shtohen sektorët që do të mbështeteshin me IPARD III", deklaroi ministrja.

"Përtej masave të aplikuar në IPARD II, në këtë program mbështeteshin dhe inkurajojmë aktorët ekonomikë që të përdorin

raca autoktone, të rivitalizojnë agrosistemet tradicionale, si për shembull ullishtet tradicionale, të rrisin sipërfaqet e certifikuar apo të shfrytëzojnë në mënyrë të qëndrueshme kullotat, burimet peshkore dhe të akuakulturës", u shpreh Krifca.

Këto masa, vijoi ajo, janë pjesë

Ullirit dhe vajit të Ullirit; bimët mjekësore dhe aromatike dhe përpunimi i produkteve të peshkimit", informoi ministrja.

Krifca tha se, "është detyrë e këtij komiteti që të detajojë hapat që këto mundësi t'i bëjnë sa më shpejt të mundura për t'u përdorur nga operatorët shqiptarë".

"Sot vijmë përpara jush me rezultate mjaft pozitive për sa i takon përmbushjes së dokumentacionit të kërkuar lidhur me procesin e marrjes së besimit për zbatimin e buxhetit të Programit IPARD III", deklaroi Krifca, teksa renditi edhe finalizimin me sukses të Marrëveshjes Sektoriale; përgatitjen dhe dorëzimin në kohë të paketës së akreditimit për Autoritetin Menaxhues dhe Agjencinë IPARD për masat që mbarten nga Programi IPARD II (masat 1, 3, 7 dhe 9) dhe përgatitjen intensive për masat e reja në IPARD III të tilla si: masa Agro-ambientale dhe bujqësia organike; Zbatimi i strategjive lokale të zhvillimit – qasja LEADER; Zbatimi në Infrastrukturën Publike Rurale; Shërbimi Ekstensiv dhe ngritja dhe mbrojtja e pyjeve.

Në këtë takim të rëndësishëm, fjalën e mori edhe Frank Bollen nga DG Agri i Komisionit Evropian. Bollen e konsideroi një ditë unike takimin e Komitetit Monitorues të IPARD II, sepse siç tha ai, "është hera e parë që Komiteti i Monitorimit mbledhet në një zonë rurale dhe mund të shikojmë në realitet jetësimin e mbështetjes në investim".

"Ju po vazhdoni të implementoni IPARD II me një ritëm shumë të mirë. Viti i kaluar nuk ishte vit i lehtë dhe kur kthejmë kokën pas, shohim ndryshimin dhe themi se po, ju ia dolët dhe ia arritët. Ky është një sinjal i mirëpritur. Ne besojmë se me angazhimet e përbashkëta do të arrijmë të implementojmë programin IPARD III me sukses. Ne do t'ju inkurajojmë", u shpreh Bollen.

Ndërsa Andea Vera nga Delegacioni i BE-së në vendin tonë, drejtues i programit të zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri, vuri në dukje se, "BE është donatori, mbështetësi dhe partneri më i madh i ekonomisë shqiptare dhe kjo është më e dukshme në fushën e zhvillimit rural dhe bujqësisë dhe kjo falë programit IPARD, por edhe projekteve të tjera që kanë mbështetur start up-et në biznese apo programe të tjera".

"Që nga viti 2018 kemi parë një implementim premtes dhe shpejtësia e zbatimit ka qenë më e shpejtë nga pritshmëritë. Faktorët kryesorë në këtë proces janë përfshirja dhe përpjekja e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe pa dyshim përkushtimit të fermerëve", deklaroi Vera.

Në takim e morën fjalën dhe sipërmarrës e fermerë, përfitues të mbështetja nga programi IPARD, të cilët përcollën eksperiencën e tyre të suksesshme në bizneset që kanë ngritur dhe por zhvillojnë në sektor të ndryshëm të ekonomisë rurale, falë granteve nga IPARD II dhe vlerësuar vijueshmërinë e mbështetjes së BE-së dhe qeverisë shqiptare për bujqësinë përmes Programit të ri IPARD III.

## INFORMACIONE

## IPARD, mbështetje 38 investimeve të reja në përpunimin e qumështit

Fermerët dhe sipërmarrësit përmes skemave mbështetëse dhe grenteve nga programi IP-

konkurruese në tregje.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural bëri të ditur



ARD po rrisin investimet në teknologjitë e reja dhe modernizimin e fermave, si domosdoshmëri e avantazheve

se, në sajë të mbështetjes nga programi IPARD II, sot 38 sipërmarrje kanë rritur standardet dhe kapacitetet e pro-

dhimit në sektorin e qumështit dhe nënprodukteve të tij.

Këto investime përfshijnë ndërtimin e stallave, pajisje dhe linja automatike mjeljeje, dhoma frigoriferike, linja përpunimi qumështi, ndërtim baxhosh, vendosjen e paneleve fotovoltaike, si edhe mekanikë bujqësore.

Pajisjet dhe teknikat e reja kanë rritur rendimentin e prodhimit dhe kanë ndihmuar në zvogëlimin e kostove për fermerët, gjithashtu pikat e grumbullimit të qumështit luajnë një rol të rëndësishëm duke ndihmuar fermerët e zonës që të shesin prodhimin e tyre.

Zgjerimi dhe zhvillimi i këtyre sipërmarrjeve ka ndikuar në nxitjen e punësimit dhe rritjen e të ardhurave në ekonominë rurale.

## Fermerët e Lushnjës, prodhimi i serrave të kontraktuar për shitje

Fermerët që prodhojnë perime në serra në Lushnjë kanë arritur që përpara mbledhjes së produkteve të tyre, t'i kenë të kontraktuara për shitje. Ata shprehen të kënaqur, pasi siç thonë vetë, cilësia e prodhimit i garanton shitjen.

Kjo është periudha e mbledhjes së perimeve në serra dhe të gjitha prodhimet janë të kontraktuara për shitje.

Ky vit duket se është i

mbarë për të gjithë kultivuesit në zonën e Kosovës së Vogël në Lushnjë. Lulëzim Ibrushi dhe Aurel Zgjana, po vjelin në serrat e tyre domaten, bishtajën dhe specin.

Ata thonë se interesi për prodhimet e zonës ka qenë i madh, madje këtë vit tregu ka kërkesa të shumta si për eksport, edhe për vendin.

Kërkesat për domaten, specat, bishtajat dhe kastravec

janë të shumta, ndërsa nuk është nevoja që prodhuesit të gjejnë tregun por këtë vit tregtarët po kërkojnë fermerët.

Për herë të parë deri më tani asnjë nga produktet perimore nuk po tregtohet nën 100 lekë për kg.

Zona e Kosovës në Lushnjë ka arritur të shesë të gjithë prodhimin dhe kultivuesit kanë rritur cilësinë duke zgjedhur varietetet më të mira.

## Rama: 5-fish fonde mbështetje për sipërmarrjet në këto 4 vite

Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me sipërmarrës të Malësisë së Madhe u ndal dhe tek bimët medicinale.

Rama tha se, bimët medicinale po bëhen një industri gjithmonë e më serioze e që kanë çarë gjithë kufijtë dhe që shkojnë kudo për eksport.

Ai u shpreh tha se, kemi fabrika këtu të agropërpunimit që që janë shembuj fantastikë, patjetër të mbështetura.

“Pashë një llogari, sa e ka mbështet këtu, se e bukura këtu është që demokratët, ka demokratë këtu se unë i njoh, demokratë të fortë biles

demokratë të fortë biles, por iu ka rënë sakica në mjaltë me PS. Ne vetëm periudhën nga 2018-2022, 4 vjet kemi dhënë fonde mbështetje këtu për gjithë sipërmarrjen pesëfishin e fondeve të dhëna përpara 2018”, theksoi Rama.

## Mbështetja nga IPARD, kompania e frutaperimeve në Lushnjë eksporton në Evropë

Kompania “Doni Fruits sh.p.k.” në Lushnjë është një ndër kompanitë më të mëdha për grumbullimin, përpunimin dhe eksportin e fruta perimeve.

Mbështetur nga AZHBR përmes programit IPARD II, kompania është pajisur me linjë kalibrimi dhe paketimi të produkteve, si edhe dhoma frigoriferike me klimë të kontrolluar për ruajtjen e cilësisë.

Produktet e “Doni Fruits” janë të certifikuar (CE) sipas standardeve të Bashkimit Evropian dhe si të tilla eksportohen në Evropë edhe më gjërë.

Ky investim ka krijuar mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës dhe nxitimit të prodhimit nga fermerët

e zonës, plotësimin e nevojave vendase dhe rritjen e eksportit.

Përmes investimeve të tilla,



të bashkëfinancuara nga Bashkimi Evropian dhe qeveria

shqiptare, synohet rritja e punësimit, përmirësimi i standardeve të jetesës dhe zhvillimi

mi i përgjithshëm i ekonomisë rurale.

## Mbështetje 500 mijë euro për ndërtimin e fermave të reja dhe bimët mjekësore

Qeveria do të mbështesë ndërtimin e fermave të reja dhe bimët mjekësore.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca në takimin në agroturizëm “Hysaj”, Gruemirë vuri theksin te mbështetja që i ka bërë Ministria e Bujqësisë sipërmarrësve që merren me bimë medicinale.

Në fjalën e saj gjatë këtij takimi ku i pranishëm është dhe kryeministri Edi Rama, Krifca tha se në Malësinë e Madhe ka njerëz që punojnë në bujqësi, bimët medicinale ku mbi 75 e bimëve mjekësore aromatike vijnë pikërisht nga Malësia e Madhe.

“Përmes vëmendjes që ka patur Ministria e Bujqësisë, së fundmi ju i keni shtuar këto sipërfaqe të kultivuara. Keni pasur mundësinë të orientonim prodhim të certifikuar dhe ajo që ka bërë tërësisht shtimin e vlerës së këtij produkti në Malësi të Madhe ka qenë mbështetja financiare që ne kemi ofruar për ndërtimin e pikave të grumbullimit të bimëve medicinale por dhe linjave të përpunimit të cilat kanë sjellë jo vetëm përmirësim të kapaciteteve ruajtëse, seleksionuese, distiluese në mënyrë që ne të mos eksportojmë dot më vetëm bimë medicinale po të eksportojmë vajin, produkte finale në mënyrë që vlera e shtuar të qëndrojë në ekonominë e Malësisë së Madhe”, tha ajo.

Krifca tha se, “e kemi hequr masën e mbjelljeve së bimëve medicinale nga skema kombëtare. E kemi hequr se pse e kemi futur të IPARD, sikundër nuk e kishim në IPARD II, në IPARD III jemi munduar me shumë negociata me Bash-

kimin Evropian që jo vetëm të vendosim të mbështesim deri në 500 mijë euro për ndërtimin e fermave të reja dhe kultivimin

më shumë nga buxheti i shtetit në mbështetje të këtyre prodhuesve në mbështetje të uljes së kostove të prodhimit. Të



e bimëve mjekësore aromatike, por dhe të adresojmë një çështje e përpunimit të bimëve mjekësore aromatike dhe fabrikave të mëdha ku mund të marrin pjesë kompanitë e mëdha me xhiro deri në 12 milionë euro”.

“Shoh këtu përfitues të mekanikës bujqësore që ka bërë të mundur transformimin e produktiviteti në ferma jo vetëm të bimëve mjekësore aromatike. Ne 10% të eksporteve bujqësore janë nga bimët mjekësore medicinale”, tha Krifca.

Krifca tha se vjet mbyllëm një vit të suksesshëm për bujqësinë, i cili ishte një vit sfida që pati një ndërprerje të zinxhirëve prodhues, transportues në të gjithë botën. Ne ia dolëm falë punës së fermerëve tanë, përpunuesve të cilët ata vazhduan të punojnë dhe ne vazhduam të mbështesim.

“I mbështetëm me 2.5 herë

njëjtë gjë bëjmë edhe këtë vit. Ndërkohë që lëvrojmë skemë kombëtare të mbështetjes dhe javën tjetër fillon shpërndarja e kartës së naftës. Në Malësinë e madhe ne kemi 100% të aplikantëve të naftës, dhe 900 që kanë aplikuar 900 do e marrin atë. 19 subjekte vetëm nga programi IPARD nga 2019 kur filloi dhe deri më tani janë përfitues të këtij programi, bëhet fjalë për 7 milionë euro që kanë ndodhur në mekanika bujqësore, fabrikë përpunimi Vetëm në Malësi të Madhe janë 6 subjekte turistike”, tha ajo.

Krifca shtoi se agroturizmi është një pikë e fortë këthese e strategjisë që ne kemi për të sjellë mirëqenie në zonat më të thella të vendit.

“Agroturizmi me shembujt e vet të suksesit ka sjellë vizitorë nga Tirana dhe turistë nga e gjithë bota në bujtina me standarde të mirëqenies”, tha ajo.

## MBZHR, projekte në bujqësi në bashkëpunim me Bankën Botërore

Banka Botërore po konsolidon bashkëpunimin në fushën e bujqësisë në Shqipëri.

Projektet mbështetëse në bujqësi, parashikojnë të shtrihen në sektorin e ujitjes dhe

duke pasur në fokus teknologjinë dhe digjitalizimin si një prej dimensioneve të strategjisë së Bankës Botërore, “do të fokusohemi në krijimin e serrave smart, të cilat mund të shfrytëzojnë energjinë diellore për prodhimin e energjisë në prodhimin bujqësor dhe sigurisht do të mbështesim forcimin e lidhjes së tregut me fermerin dhe të eksporteve, si objektivi final për të gjithë fermerët”.

335 milionë USD është shuma e 4 projekteve të para pritet të nisnin në Shqipëri nga Banka Botërore. Këto investime janë pjesë e strategjisë 4-vjeçare të BB adresuar për Shqipërinë, që kap një vlerë totale prej 900 milionë USD.

Zbatimi i projekteve do të nisë menjëherë pas miratimit në Parlament të marrëveshjeve që BB adreson për ekonominë shqiptare.

Investimet e BB në Shqipëri kanë si synim të krijojnë sa më shumë vende pune në zonat ku do të realizohen këto projekte si dhe digjitalizimin e shërbimeve për qytetarët.



Bujqësia dhe zhvillimi rural është sektor me rëndësi të veçantë ku do të investojë shumë shpejt Banka Botërore, përmes disa projekteve.

Në bashkëpunim me ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, Banka Botërore ka parashtruar tashmë dizajnimin e projekteve në mbështetje të fermerëve, zgjerimin e punësimit në sektorin rural dhe zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri.

kullimit, kryesisht në rajonin e Divjakës, krijimin e serrave “smart” me ngrohje diellore, forcimin e lidhjes mes fermerëve dhe tregut dhe nxitjen e eksporteve bujqësore.

Evis Sula përgjegjëse për mbikëqyrjen e projekteve të BB-së në Shqipëri, në një intervistë televizive tha se, “BB do të ndërhyjë në përmblylljen e disa kanaleve vaditëse në zonën e Divjakës”.

Gjithashtu, informoi ajo,

## Certifikimi i farave dhe fidanëve, Qeveria: Mbështetje për mbi 900 ha serra

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca zhvilloi një takim me fermerë, të cilët janë përfutur të masave për certifikimin e farave dhe fidanëve.

Gjatë takimit ministrja informoi se, “masa e re e fara dhe fidanëve të certifikuar e aplikuar për herë të parë vjet, mbështeti mbi 900 ha serra”.

“Ky instrument i ri për mbështetjen e farave dhe fidanëve të certifikuar, u vjen në ndihmë fermerëve të prodhojnë dhe të ruajnë prodhimin dhe të mbështeten për kostot e prodhimit”, tha Krifca.

Numërohen rreth 5 mijë fara të ndryshme dhe dru-frutorë me origjinë shqiptare të mbledhura nga i gjithë territori jonë.

Ky koleksion fushor ruhet në Bankën Gjenetike si një fikimit. Ka patur dhe një sasi më të madhe fermerësh që këtë



pasuri bimore e jashtëzakonshme, i cili ruhet në Norvegji, ku është banka kombëtare e ruajtjes së farave botërore.

Vitin e kaluar rreth 1 mijë hektarë prodhimi perimor janë mbështetur për shkak të certi-

vit kanë aplikuar. Certifikimi i farave dhe fidanëve i japin një garanci dhe konsumatorit tonë vendor, por edhe konsumatorëve në tregjet e kualifikuara ku synohet çuarja e produkteve për eksport.

## Ish-emigrantët bëhen fermerë, katër vëllezërit mbjellin bajame në Roskovec

Pas më shumë se dy dekadave emigrim në Greqi 4 vëllezë Bilbili, Demiri, Agroni dhe Durim Gega, janë kthyer në vendlindjen e tyre në Kurjan të Roskovecit duke investuar në mbjelljen e 42 dylmëve me bajame apo rreth 1000 pemë të kësaj kulture.

Kryesisht sipërfaqja më e madhe e kësaj zone është e njohur për ullishtet, ndaj 4 vëllezërit po lënë shenjë në fshat për një kulturë të re bujqësore.

“Vendimi për të mbjellë një sipërfaqe prej 4,2 ha nuk ishte i thjeshtë por duke parë se ky frut importohet nga Greqia

dhe kërkesat janë të shumta të tregut vendas, vendosëm që të merrnim fidanët në Greqi dhe të kemi sot këtë sipërfaqe me 1000 pemë bajame. Si çdo fillim ka qenë i vështirë por megjithatë sot jemi të kënaqur në treg prodhimin dhe shitjen në treg. Vitin që kaloi që ishte edhe prodhimi i parë morëm rreth 20 quintal bajame ndërkohë që këtë vit pritet një dyfishim i prodhimit”.

Katër vëllezërit Gega krahan kontributit të tyre në tokat e të parëve, kërkojnë edhe mbështetjen e shtetit për zhvillimin e sipërmarrjes së tyre.

“Ndihma nga shteti ka qenë subvencioni në karburant ndërkohë kemi aplikuar edhe për këtë vit. Problemi që po përballemi është ujitja. Për shkak të relievit kodrinor në plantacionin me bajame deri tani kemi marrë ujë në vështirësi. Kemi hapur një pus por kërkojmë shtimin e linjës së energjisë elektrike që të instalojmë pompat”.

Por vëllezërit që kanë bashkuar të ardhurat në kultivimin e bajames i janë përkushtuar edhe kulturave të tjera, duke mbjellë rreth 6 ha sipërfaqe me grurë si dhe mbjelljen në 2 ha me frutin e shegës.

## Balla: Nga Lushnja çdo ditë eksportohen perime drejt BE-së

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla mori pjesë në hapjen e Panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë, Teknologjive, Ushqimit dhe Përpunimit, i cili është kthyer në një traditë për Lushnjën.

Në fjalën e tij Balla tha se, Lushnja furnizon çdo ditë me perime gjithë Ballkanin dhe jo vetëm.

“Ky panair tregtar që po zhvillohet në Lushnjë, do të shërbejë për të diskutuar për atë që është një prej binarëve kryesor të ekonomisë së Shqipërisë, bujqësia. Nuk ka një vend tjetër

ku mund të zhvillohet një panair kaq i madh për bujqësinë sesa në Lushnjë. Ndaj dhe falënderoj të gjithë bujqit e Myzeqesë e të gjithë Shqipërisë për punën që bëjnë çdo ditë dhe për rritjen e fuqisë eksportuese të Shqipërisë”, tha ai.

Balla tha se “më në fund në Lushnjë do të ketë një qendër të madhe grumbullimi dhe përpunimi që do jetë një investim nga buxheti i shtetit për të krijuar një model për të kaluar nga bujqësia e lëndës së parë, të shkojmë në një nivel tjetër të përpunimit”.

“Prandaj ajo që vlen të pjesa e certifikimit ka të bëjë edhe me

vajin e ullirit. Gjëja e mirë që ka ndodhur është ajo marrëveshje midis ministres së Bujqësisë dhe ministrit italian i cili i ka dhënë efektet. Mjaftoi ai kontakt dhe ajo marrëveshje dhe do të kemi 4 milionë euro eksport vaj ulliri brenda 4-5 javëve dhe kjo është një gjë shumë e mirë, sepse po na çliron nga një hall që ka zënë të gjithë ata që kanë prodhuar prej vitesh vaj ulliri”, tha ai.

Po ashtu, Balla theksoi se “nevoja për të pasur një plan kombëtar vaditjeje është një nevojë jetike për bujqësinë”.

## Me mbështetjen e IPARD, fabrika e tharjes së frutave në Berat eksporton në BE dhe SHBA

Me mbështetjen e Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, përmes programit IPARD, “Gjedra” shpk në Berat, një kompani e specializuar në grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekësore, bashkëpunon me 3500 fermerë të zonës dhe eksporton produktin final të saj në tregjet e Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

kjo sipërmarrje është shndërruar në një ndër eksportueset kryesore të bimëve mjekësore në Evropë edhe më gjerë.

Përveç tregut të bimëve mjekësore, “Gjedra” e ka zgjeruar portofolin e produkteve që përpunon dhe eksporton, duke përfshirë edhe frutat e ndryshme, kryesisht mollën dhe boronicën.

Në sajë të financimit nga programi IPARD II, u mundësua ndërtimi i një magazine të re

për ruajtjen e bimëve, si edhe u investua në makineri për tharjen e frutave, duke ruajtur vlerat e produktit në përputhje me standardet evropiane të cilësisë.

AZHBR, përmes programeve të mbështetjes, ka rritur të ndihmojë në ndërtimin e sipërmarrjeve të cilat shërbejnë si modele suksesi në sektorë të ndryshëm të bujqësisë, duke kontribuar në uljen e papunësisë, rritjen e të ardhurave dhe zhvillimin rural.

## AKU: Kontrolllet për sigurinë ushqimore sipas BE-së, garantojmë konsumatorin nga ferma në tavolinë

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare garantuan sot konsumatorin se ushtrojnë jo vetëm kontrolle të vazhdueshme, por edhe sipas protokolleve europiane të sigurisë ushqimore në gjithë zinxhirin nga ferma në tavolinë.

Autoritetet e sigurisë ush-

Meçaj tha se, në vitin 2022 është rritur numri i kampioneve të cilat analizohen.

“Janë planifikuar 1958 kampione, 500 kampione më shumë se niveli minimal detyrim në planifikim mbi bazë të prodhimit vjetor për produktet bujqësore. Për këto 1958 kampione janë realizuar 3041 analiza,

iptare, që në vitin 2022 preken shifrën e 242 mijë tonë eksporte në 80 shtete të botës”, theksoi Deda.

Ajo informoi publikun se përdorimi dhe kontrolli mbetjeve të pesticideve në produktet bujqësore, kryhet bazuar në planin me bazë rrisht për bizneset dhe kulturat bujqësore, plan siç tha Deda, “është hartuar me mbështetjen e ekspertizës më të mirë europiane”.

Për të forcuar sigurinë ushqimore në vendin tonë, me mbështetjen e BE-së përmes projektit IPA për Sigurinë Ushqimore, dhe me ndryshimet ligjore të ndodhura, nga viti 2022 aplikohet dhe regjistri i përdorimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve në fermë (fletorja e fermerit, e cila kontrollon dhe në pikat e grumbullimit nga AKU).

Deda bëri të ditur se, nga totali i eksporteve bujqësore, në sistemin alert RASFF (sistemi i njoftimit të menjëhershëm për ushqimin) të Bashkimit Evropian, janë sinjalizuar vetëm 5 ngarkesa gjatë të gjithë vitit.

Sipas saj, pesticidi i konstatuar si mbetje në këto ngarkesa është përfshirë menjëherë në planin e monitorimit të këtij viti.

“Siguria ushqimore është një proces në zhvillim i cili mbështetet në monitorim, ndjekje të rasteve jo konform dhe përmirësim të parametrave të ndryshëm. Është e rëndësishme të mos bëjmë politikë mbi sigurinë ushqimore, duke përfshirë panik për produktin bujqësor vendas, kur nuk është ky rasti, por të lejojmë strukturat që të bëjnë punën e tyre, me rigorozitet dhe në funksion vetëm të konsumatorit”, deklaroi drejtoresha e AKU-së, Jeta Deda.



qimore në vend po ashtu, vunë në dukje se vendi ynë aplikon plan unik të njëjtë me vendet e Bashkimit Evropian, për kontrollin e mbetjeve të produkteve veterinarë në kafshë të gjalla dhe produkte shtazore, duke garantuar siguri ushqimore në tregjet e vendit dhe mbrojtje të shëndetit të konsumatorit.

Drejtoresha e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) Jeta Deda dhe drejtori i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV) Roland Meçaj, deklaruan sot në një konferencë të përbashkët për shtyp se, “kontrolli i produkteve sipas këtij plani, përcaktohet me formulë të gatshme sipas direktivave të BE dhe aplikohet në bazë të prodhimit kombëtar për produktet e mjaltit, vezëve, peshkut etj.”.

pra një mesatare 1.5 analiza për një kampion. Nga këto kanë rezultuar 59 raste mbi normë pra rreth 3 % e totalit. Çdo rast jo konform është ndjekur bazuar në ligj nga strukturat përgjegjëse për të zbuluar hallkën e zinxhirit e cila ka nevojë të përmirësohet”, tha Meçaj.

“Qëllimi i këtij monitorimi është mbulimi i kontrollit të të gjithë zinxhirit ushqimor nga kafshët, tek farmacitë veterinarë dhe deri te konsumatori final”, deklaroi Meçaj.

Drejtoresha e AKU-së, Jeta Deda deklaroi se “Ministria e Bujqësisë ka prioritet sigurinë ushqimore nga ferma në tavolinë”.

“Produktet bujqësore shqiptare janë të pastra nga mbetjet e pesticideve dhe këtë fakt e konfirmojnë eksportet në rritje të prodhimeve bujqësore shq-

## Mbahet Forumi i biznesit Shqipëri-Gjermani: Potencial investimesh në bujqësi

“Bujqësia është një ndër sektorët me portencialin më të madh për investimet e huaja”, u shpreh ministrja e Bujqësisë

të ndryshme, ministrja Krifca parashtrij një sërë sektorësh në fushën e bujqësisë dhe ushqimit që e bëjnë Shqipërinë

më pak produkte plehëruese se sa mesatarja e BE-së. Sektori i peshkimit detar prej 450 anijesh së bashku me prodhimet e akuakulturës gjenerojnë më shumë se 80 milion euro eksporte në vit. Ky sektor mbështetet nga një njësitë e përpunimit të cilat eksportojnë produkte të përpunuara të detit në të gjithë botën dhe që krijojnë mundësi të mëdha punësimi në mënyrë të veçantë për të rinjtë dhe gratë”, u shpreh Krifca.

Ministrja parashtrij blegtorinë dhe zinxhirin e vlerës së mishit dhe të produkteve blegtoriale, si një mundësi të mirë dhe e vyer bashkëpunimi me sipërmarrjet e huaja, në procesin e e ristrukturimit të zinxhirit të vlerës, dhe forcimit të sigurisë ushqimore në sektor.

Gjithajshu, tha Krifca, Shqipëria është një vend mesdhetar që dallohet për produktet emblematike siç janë vreshti, vera, ulliri, vaji i ullirit e bimët aromatike .



dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca në forumin e biznesit Shqipëri-Gjermani që u zhvillua në Tiranë.

Duke marrë fjanën në forumin që mbledhi bashkë dhjetëra përfaqësues të biznesit nga të dy vendet dhe nga institucione

konkurruese dhe tërheqëse për investimet e huaja.

“Shqipëria është vend që prodhon pothuajse totalisht në mënyrë organike. Treguesit e Organizatës Botërore të Ushqimit, FAO, dëshmojnë se bujqësia Shqiptare përdor 4 herë

## SHKK

## Fondi i sigurimit të depozitave të SHKK-ve arrin në 1.7 milionë euro

Unionit Shqiptar Kursim Kredi (USHKK) në Shqipëri, pararendësit të kooperativës më të madhe financiare në vend, sot SHKK FED invest. Thëllimi i tij shënoi një hop të madh cilësor dhe hapi një prespektivë të re për kreditimin rural në përgjithësi. Zonat ku Unioni është prezent, u shndërruan në të vetmen referencë për të gjithë ata individë, të cilët kishin ide dhe aftësi për të zhvilluar fermerin dhe që synonin të përmirësonin ekonominë e familjeve të tyre. Sot ky institucion operon me sukses në kreditim e bujqësisë dhe fermerëve.

Fondi i sigurimit të depozitave në shoqëritë e kursim kreditit u rrit me 15.4% vitin e kaluar.

Sipas informacionit të Agjencisë për sigurimin e Depozitave ky fond arriti vlerën e 192 milionë lekëve ose pothuajse 1.7 milionë eurove në fund të vitit 2022.

Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi (investimi) i mjeteve financiare.

Të ardhurat për vitin 2022 arritën në rreth 26.4 milionë lekë, nga të cilat të ardhurat nga primet e sigurimit ishin 21.1 milion lekë, ndërsa të ardhurat nga investimi ishin 5.3 milionë lekë.

Tashmë, raporti i mbulimit të depozitave të siguruar në SHKK prej fondit të administruar nga ASD ka arritur në 2.61%, nga 2.42% që kishte qenë një vit më parë. Raporti i mbulimit është ndjeshëm më i ulët krahasuar me atë të de-

pozitave në banka, që në fund të vitit 2022 arriti në 7%. Por, skema e sigurimit të depozitave në SHKK është më e re në kohë.

Ngritja e këtij fondi nisi në vitin 2015, me ndryshimet e ligjit 'Për sigurimin e depozitave', që përfshinë edhe SHKK-të në skemën e sigurimit të depozitave, deri në 2 milionë lekë për çdo depozitues.

Në janar të vitit 2015, u arkëtuua nga Buxheti i Shtetit fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK në vlerë 76 milion lekë, që siguroi bazën fillestare financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.

Duke nisur nga viti 2015 e në vazhdim, Agjencia ka administruar mjetet financiare të fondit

të sigurimit të depozitave në SHKK, të cilat hynë në skemë vetëm në fillim të vitit 2017, për shkak të kohës së nevojshme për përbushjen e kriterëve ligjore për përfshirjen në të.

Sigurimi bëhet efektiv vetëm në momentin kur SHKK-ja përkatëse anëtarësohet në skemën

e sigurimit të ASD-së. Për këtë qëllim, SHKK-të duhet të certifikohen dhe të marrin një vërtetim të përbushjes së kriterëve nga Këshilli Drejtues i ASD-së.

Sipas Bankës së Shqipërisë, aktualisht në Shqipëri veprojnë 11 SHKK aktive, ndërsa Agjencia e Sigurimit të Depozitave

(ASD) raporton nëntë subjekte të anëtarësuara në skemën e sigurimit të depozitave.

Përfshirja në skemën e sigurimit të depozitave vlerësohet se ka pasur një rol të rëndësishëm në rritjen e sektorit të SHKK-ve në vitet e fundit. Totali i aktiveve të tregut në fund të vitit 2022 arriti vlerën e 14.36 miliardë lekëve ose afërsisht 127 milionë eurove. Krahasuar me një vit më parë, tregu i shoqërive të kursim-kreditit u rrit me 8.2%.

Në fund të vitit 2022, depozitat në SHKK prekën shifrën e 10.4 miliardë lekëve, në rritje 8.3% me bazë vjetore. Ndryshe nga sa ndodh për sektorin bankar, depozitat e SHKK-ve dominohen në masën 80% nga depozitat në monedhën vendase. Sipas ASD-së, depozitat e siguruar për SHKK-të ishin rreth 7.4 miliardë lekë ose 6.9% më shumë se një vit më parë.



## Guri: Mbështetja për bujqësinë e dyfishuar, ulje e kostove të prodhimit për fermerët



për shkak të klimës që kemi”.

Kështu u shpreh sot në një intervistë televizive, Fatmir Guri, profesor në Universitetin Bujqësor të Tiranës, përgjegjës i departamentit të Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural, ku bëri të ditur se, “nëse në vitet 2017-2019 niveli i mbështetjes për bujqësinë shkonte rreth 2.6 miliardë lekë, në vitin 2022 kjo mbështetje financiare është tejkaluar në dyfishim fondesh”.

Sipas tij, rritja e mbështetjes për bujqësinë ka ardhur, në përgjigje të vështirësive të rëndësishme që shënuan tregjet dhe inputet, nga kriza e luftës në Ukrainë.

“Në këto kushte edhe mbështetja ka qenë e kon-

siderueshme duke lehtësuar fermerët në uljen e kostove të prodhimit”, tha Guri.

Profesori e argumentoi këtë, me numrin rekord të aplikimeve që regjistroi ky vit për të gjitha skemat e mbështetjes në bujqësi.

“Fermerët janë shpërblyer dhe e shohin si mundësi për rritjen e aktivitetit të tyre ekonomik”, deklaroi Guri, teksa vuri në dukje se, një sërë projekte janë në zbatim bashkë me donatorët në fushën e bujqësisë në Shqipëri (sisteme vaditje, kanale kulluese, tregje, rrugë rurale etj) që po ndikojnë në ecurinë pozitive të bujqësisë dhe rritjen e kontributit të këtij sektori në PBB, punësim dhe rritje të ardhurash në ekonominë rurale.

## Grant deri në 70% të investimit në energji të rinovueshme, Krifca: Mbështetje edhe me IPARD III

Energjia e rinovueshme është një nga sektorët që mbështet programi IPARD II, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe qeveria shqiptare.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, bëri të ditur se, deri tani janë financuar 27 sipërmarrje për vendosjen e paneleve fotovoltaike, ku përfshihen stallet, magazinat për ruajtjen e produkteve, bujtinat, linjat e përpunimit etj.

“Programi IPARD II, financon grante nga 50 % deri në 70 % të vlerës së investimit për prodhimin e energjisë së rinovueshme në sektorin e bujqësisë”, informoi ministrja.

Sipas saj, kjo është një mënyrë shumë e mirë për kursimin e energjisë elektrike dhe pakësimin e kostove për fermerët, përmes

ndërtimit të paneleve fotovoltaike në sipërmarrjet rurale, kursen deri në 90% të konsumit të en-

ekonominë fermere.

“Fermerët dhe sipërmarrjet rurale, do të përfitojnë nga një



ergjisë elektrike.

Krifca tha se, mbështetja për të këtë sektor do të vijojë edhe në programin IPARD III, me qëllim uljen e kostove për

akses më i gjerë në financim për projekte të ruajtjes energjetike, falë edhe programit IPARD III, që nis vitin që vjen”, theksoi ministrja Krifca.

## Mbahet Forumi i biznesit Shqipëri-Gjermani: Potencial investimesh në bujqësi

(Vijon nga faqja 5)

“Tradita, varietetet autoktonë të vreshtit dhe të ullinjve si pasuri kombëtare dhe tregues i identitetit të veçantë të vendit tonë, janë kthyer në një mundësi për të rindërtuar sektorin e prodhimit të verës në Shqipëri me investime të rëndësishme në krijimin e kantineve të reja të cilat e kanë drejtuar prodhimin e tyre nga cilësia dhe janë të suksesshëm në panairt ndërkombëtare. Vaji i ullirit shqiptar sot gjendet në tregje të sofistikuara dhe eksportohet deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shqipëria është një ndër 25 eksportuesit më të rëndësishëm në nivel global për bimët mjekësore. 92% e prodhimit vjetor prej 15 mijë tonësh shkon për eksport ku një pjesë e rëndësishme (70%) shkon në tregjet më të rëndësishme botërore si Gjermania, vendet e tjera të BE dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, informoi ministrja.

Duke u ndalur tek trendi i ri në rritje i eksporteve bujqësore,

Krifca vuri në dukje se, prodhimet bujqësore “Made in Albania” po kërkohen gjithë e më shumë nga tregjet e huaja duke zgjeruar gjeografinë e vendeve deri në Azi, vendet skandinave, SHBA etj.

“Sot bujqësia zë mbi 66% të volumit të sasisë së eksporteve dhe 43% të vlerës së eksporteve totale që Shqipëria realizon”, shtoi ajo.

“Kemi të shpërndarë në të gjithë vendin një rrjet prej më shumë se 400 pika grumbullimi të cilat drejtojnë produktet tona të freskëta apo të përpunuara në më shumë se 82 destinacione në botë. Si një eksportues i rëndësishëm rajonal, Shqipëria arriti që vitin e shkuar të eksportonte 500 milion dollarë produkte bujqësore, duke iu afruar objektivit madhor të eksportimit të 1 miliardë dollarëve në vitin 2030”, tha ajo.

Ministrja tha se ka lidhur një partneritet me Ministrinë e Bujqësisë në Gjermani.

“Këtë vizitë të këtyre bizneseve e kemi marrë shumë seri-

ozisht si qeveri dhe jemi të gatshëm të ofrojmë gjithë hapësirën e bashkëpunimit në mënyrë që disa nga këto biznese të kenë mundësinë të shtrihen në Shqipëri, të krijojnë partneritete me biznesin shqiptar apo mundësi të hapin edhe filialet e tyre në vendin tonë”, tha Krifca.

Ministrja shprehu bindjen se, mundësitë për të zhvilluar më tej këtë sektor nëpërmjet investimeve të reja dhe përdorimit të teknikave novatore dhe inteligjente, janë të pafundme.

“Ne jemi të hapur për çdo bashkëpunim i cili synon rritjen e kapaciteteve prodhuese të aktorëve të biznesit, rritjen e kapacitetit të tyre për inovacion dhe bashkëpunim, forcimin e lidhjeve me tregjet ndërkombëtare nëpërmjet rritjes së shërbimeve, të ruajtjes dhe përpunimit”, deklaroi ajo.

Një fjalë përshëndetëse në aktivitet mbajti edhe ambasadori i Gjermanisë në Shqipëri, Peter Zingraf, i cili tha se mbështetja zgjerohet në disa fusha të rëndësishme.

## Formalizim i mjeteve bujqësore të blera në kohën e eksodit nga Kosova

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit

nga koha e eksodit kosovar në Shqipëri, të blera rregullisht

pronësie.

Qindra mjete bujqësore, rimorkio e agregat, deri sot të paregjistruara, po kryejnë targimin me procedura të lehtësuara, vetëdeklarim e kontroll fizik aty ku jetojnë e punojnë, duke ua kursyer kilometrat e kostot drejt rajonaleve të shërbimeve të transportit rrugor.

“Sot ky problem i mbartur, që pengonte prej vitesh poseduesit e përdoruesit e këtyre mjeteve, aq të nevojshme në punë fshati e transport prodhimi bujqësor, duke krijuar rrezik në qarkullim e mosnjohje shpenzimesh, pasiguri e vështirësi për ekonominë e tokës, konsiderohet i zgjidhur”, bëri të ditur DPSHTRR.

DPSHTRR thekson se fermerët do të bëjnë kërkesën për regjistrim të mjeteve në zyrën e bujqësisë pranë njësive administrative dhe rastet do të ndiqen nga DRSHTTR-ja e qarkut.



Rrugor në bashkëpunim me Doganën Shqiptare, do të ndihmojnë bujqit dhe fermerët për formalizimin e mjeteve bujqësore që janë përfituar

por në kushtet kur të ardhurit nga Kosova, e cila ndodhej nën genocid e luftë spastrimi etnik, nuk kishin mundur të kryenin transaksione e kalime zyrtare

# Raporti Global për Krizat Ushqimore: Numri i njerëzve që përballen me pasiguri akute ushqimore u rrit në 258 milionë në 58 vende në 2022

*Goditjet ekonomike faktorët kryesorë të krizave ushqimore; lufta në Ukrainë kontribuoi në pasigurinë akute ushqimore dhe kequshqyerjes*

Numri i njerëzve që përjetojnë pasiguri akute ushqimore dhe kërkojnë ndihmë urgjente për ushqim dhe jetesë u rrit për të katërtin vit radhazi në 2022, me mbi një çerek miliardë, të cilët përballen me urinë akute, dhenjerëz në shtatë vende janë në prag të urisë, sipas Raportit Global mbi Krizat Ushqimore (GRFC).

Raporti vjetor, i prodhuar nga Rrjeti i Informacionit të Sigurisë Ushqimore (FSIN), u prezantua sot nga Rrjeti Global Kundër Krizave Ushqimore (GNAFC)- një aleancë ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, agjencive qeveritare dhe joqeveritare, që punojnë së bashku për trajtimin e krizave ushqimore.

Raporti gjetise rreth 258 milionë njerëz në 58 vende dhe territore u përballën me pasiguri akute ushqimore në nivele krize ose më keq (IPC/CH Faza 3-5) në vitin 2022, nga 193 milionë njerëz në 53 vende dhe territore në 2021. Ky është numri më i lartë në historinë shtatëvjeçare të raportit. Megjithatë, pjesa më e madhe e kësaj rritjeje reflekton një rritje të popullsisë së analizuar. Në vitin 2022, ashpërsia e pasigurisë akute ushqimore u rrit në 22.7 për qind, nga 21.3 për qind në vitin 2021, por mbetet në mënyrë të papranueshme e lartë dhe nënvizon një tendencë përkeqësimi të pasigurisë akute ushqimore globale.

“Më shumë se një çerek miliardë njerëz tani po përballen me nivele akute të urisë dhe disa janë në prag të urisë. Kjo është e pandërgjegjshme”, shkroi Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së António Guterres në parathënien e raportit. “Ky botim i shtatë i Raportit Global mbi Krizat Ushqimore është një thirrje therëse e dështimit të njerëzimit për të bërë përparim drejt Objektivit 2 të Zhvillimit të Qëndrueshëm për t’i dhënë fund urisë dhe për të arritur sigurinë ushqimore dhe përmirësimin e të ushqyerit për të gjithë.”

Sipas raportit, më shumë se 40 për qind e popullsisë janë në Fazën 3 ose më lart e IPC/CH, në pesë vende - Afganistan, Republikën Demokratike të Kongos, Etiopi, pjesë të Nigerisë (21 shtete dhe Territori Federal i Kryeqytetit - FCT), dhe Jemenit.

Njerëz në shtatë vende u përballën me urinë dhe varfërinë, ose nivelet e katastrofës së urisë akute (IPC/CH Faza 5) në një moment gjatë vitit 2022. Më shumë se gjysma e tyre ishin në Somali (57 përqind), ndërsa rrethana të tilla ekstreme ndodhën gjithashtu në Afganistan, Burkina Faso, Haiti (për herë të parë në historinë e vendit), Nigeria, Sudani i Jugut dhe Jemeni.

Rreth 35 milionë njerëz përjetuan nivele emergjente të urisë akute (IPC/CH Faza 4) në 39 vende, me më shumë se gjysma e tyre të vendosura në

vetëm katër vende - Afganistan, Republikën Demokratike të Kongos, Sudan dhe Jemen.

Për më tepër, në 30 nga 42 faktorët kryesorë të krizave ushqimore të analizuar në raport, mbi 35 milionë fëmijë nën moshën pesë vjeç vuajnë nga kequshqyerja akute, me 9.2 milionë prej tyre me humbje të rënda, forma më kërcënuese për jetën, kequshqyerjenshi një kontribues kryesor në rritjen e vdekshmërisë tek fëmijët.

sisë në prodhimin dhe tregtinë globale të karburanteve, inputeve bujqësore dhe mallrave ushqimore thelbësore, veçanërisht grurit, vajit të misrit dhe lulediellit. Lufta në Ukrainë ndërpreu prodhimin bujqësor dhe tregtinë në rajonin e Detit të Zi, duke shkakuar një kulm të paprecedentë të çmimeve ndërkombëtare të ushqimeve në gjysmën e parë të vitit 2022. Ndërsa çmimet e ushqimeve kanë rënë që atëherë, falë edhe Iniciativës së

likti u konsiderua si shtytësi kryesor në 24 vende/territore me 139 milionë njerëz në këto faza të pasigurisë akute ushqimore. Vlerësimi më i ulët shpjegohet me faktin se goditjet ekonomike tejkaluan konfliktin si nxitësi kryesor i pasigurisë akute ushqimore në tre vende ende të prekura nga krizat e zgjatura - Afganistani, Sudani i Jugut dhe Republika Arabe Siriane.

• Ekstremet e motit/klimës ishin nxitësi kryesorë të pasig-

të madhe rritja e investimeve bazë për të trajtuar shkaqet rrënjësore të krizave ushqimore dhe kequshqyerjes së fëmijëve. Kjo nënkupton bërjen e sistemeve agroushqimore më të qëndrueshme dhe më gjithëpërfshirëse, duke përfshirë përdorimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë, aksesin gjithëpërfshirës në ushqim dhe zbutjen e rrezikut. Ka gjithashtu nevojë për investime të shtuara në parandalimin, zbulimin e hershëm

perspektivë të zymtë, ndërsa konfliktet dhe pasiguria ka të ngjarë të vazhdojnë.

Sipas parashikimeve të vitit 2023 të disponueshme për 38 nga 58 vendet/territoret që nga marsi 2023, deri në 153 milionë njerëz (ose 18 përqind e popullsisë së analizuar) do të jenë në fazën 3 të IPC/CH ose më lart. Për më tepër rreth 310 000 njerëz parashi kohet të jenë në fazën 5 të IPC/CH në gjashtë vende - Burkina Faso, Haiti, Mali, pjesë të Nigerisë (26 shtete dhe FCT), Somalia dhe Sudani i Jugut, me pothuajse tre të katërtat e tyre në Somali.

## Shënim për redaktorët

Pasiguria akute ushqimore është kur paaftësia e një personi për të konsumuar ushqim të mjaftueshëm e vë jetën ose jetesën e tyre në rrezik të menjëhershëm. Ai bazohet në masat e pranuar ndërkombëtarisht të urisë akute, të tilla si Klasifikimi i Fazës së Sigurisë Ushqimore të Integruar (IPC) dhe Harmonizimi i Kuadrit (CH). Nuk është njësoj si uria kronike, siç raportohet çdo vit nga raporti vjetor i OKB-së për Sigurinë Ushqimore dhe Ushqyerjen në Botë (SOFI). Uria kronike është kur një person nuk është në gjendje të konsumojë mjaftueshëm ushqim për një periudhë të gjatë për të mbajtur një mënyrë jetese normale dhe aktive.

## Rreth Rrjetit Global dhe Raportit Global

I themeluar në vitin 2016, Rrjeti Global Kundër Krizave Ushqimore bashkon Bashkimin Evropian, FAO, UNICEF, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, WFP dhe Bankën Botërore në një partneritet unik për të përmirësuar analizën, provat dhe konsensusin mbi prevalencën dhe ashpërsinë e krizave ushqimore; të përmirësojë përpjekjet kolektive për të parandaluar dhe për t’iu përgjigjur këtyre krizave; dhe të përmirësojë të kuptuarit e shkaqeve themelore dhe ndërlidhjeve midis krizave ushqimore dhe goditjeve të tjera përtej ushqimit.

Raporti Global mbi Krizat Ushqimore është botimi kryesor i Rrjetit Global dhe është prodhuar nga Rrjeti i Informacionit të Sigurisë Ushqimore (FSIN). Që nga viti 2016, raporti ka ofruar një panoramë gjithëpërfshirëse globale mbi shkallën dhe përmasat e krizave ushqimore duke përpiluar analizat kryesore globale, rajonale dhe kombëtare të sigurisë ushqimore përmes një procesi transparent dhe të bazuar në konsensus që përfshin 16 partnerë ndërkombëtarë, dhe synon në informimin dhe promovimin e veprimeve humanitare në kohë, me kosto efektive dhe të bazuara në nevojë, si dhe për ndërtimin e qëndrueshmërisë.



Ndërsa konfliktet dhe ngjarjet ekstreme të motit vazhdojnë të nxisin pasigurinë akute ushqimore dhe kequshqyerjen, pasojat ekonomike të pandemisë COVID-19 dhe efektet e luftës në Ukrainë janë bërë gjithashtu nxitësi kryesorë të urisë, veçanërisht në vendet më të varfra të botës, kryesisht për shkak të varësisë së tyre të lartë nga importet ushqimore dhe inputeve bujqësore dhe cenueshmërisë ndaj goditjeve globale të çmimeve të ushqimit.

### Faktorët kyç

Goditjet ekonomike e kanë tejkaluar konfliktin si nxitësi kryesor i pasigurisë akute ushqimore dhe kequshqyerjes në disa kriza të mëdha ushqimore. Goditjet kumulative ekonomike globale, duke përfshirë rritjen e çmimeve të ushqimeve dhe ndërprerjet e rënda të tregjeve, minojnë elasticitetin dhe kapacitetin e vendeve për t’iu përgjigjur goditjeve ushqimore.

Gjetjet e raportit konfirmojnë se ndikimi i luftës në Ukrainë ka pasur një ndikim negativ në sigurinë globale të ushqimit për shkak të kontributit të madh të Ukrainës dhe Ru-

Kokrrave të Detit të Zi (Black Sea Grain Initiative) dhe Rrugët e Solidaritetit të Bashkimit Evropian, lufta vazhdon të ndikojë në sigurinë ushqimore në mënyrë indirekte, veçanërisht në vendet me të ardhura të ulëta të varura nga importet ushqimore, qëndrueshmëria e brishtë ekonomike e të cilave tashmë ishte goditur nga pandemia COVID-19.

### Ndarja e faktorëve kryesorë:

• Goditjet ekonomike (duke përfshirë ndikimet socio-ekonomike të COVID-19 dhe pasojat e luftës në Ukrainë) u bënë faktorët kryesorë në 27 vende me 83.9 milionë njerëz në IPC/CH Faza 3 ose më lart ose ekuivalente - nga 30.2 milionë njerëz në 21 vendet në vitin 2021. Qëndrueshmëria ekonomike e vendeve të varfra është ulur në mënyrë dramatike gjatë tre viteve të fundit dhe tani ato përballen me periudha të zgjatura rikuperimi dhe më pak aftësi për të përballuar goditjet e ardhshme.

• Konflikti/pasiguria ishte shtytësi më i rëndësishëm në 19 vende/territore, ku 117 milionë njerëz ishin në IPC/CH Faza 3 ose më lart ose ekuivalente. Në vitin 2021, konf-

urisë akute ushqimore në 12 vende ku 56.8 milionë njerëz ishin në IPC/CH Faza 3 ose më lart ose ekuivalente, më shumë se dyfishi i numrit të njerëzve (23.5 milionë) në tetë vende në 2021. Këto ekstremepërfshinin thatësirën e qëndrueshme në Brrin e Afrikës, përmblytjet shkatërruese në Pakistan dhe stuhitë tropikale, ciklonet dhe thatësirën në Afrikën Jugore.

### Zhvendosja e paradigmes

Komuniteti ndërkombëtar ka bërë thirrje për një ndryshim të paradigmes drejt parandalimit, parashikimit dhe synimit më të mirë për të adresuar shkaqet rrënjësore të krizave ushqimore, në vend që t’i përgjigjet ndikimeve të tyre kur ato ndodhin. Kjo kërkon qasje novatore dhe përpjekje më të koordinuara nga organizatat ndërkombëtare, qeveritë, sektori privat, organizatat rajonale, shoqëria civile dhe komunitetet.

Aktivitetet duhet të përqendrohen në asistencë humanitare më efektive, duke përfshirë qasjet novatore siç janë veprimet paraprake dhe rrjetet e sigurisë që reagojnë ndaj goditjeve. Nga perspektiva e zhvillimit, është me rëndësi

dhe trajtimin e fëmijëve.

“Kjo krizë kërkon ndryshime thelbësore, sistematike. Ky raport e bën të qartë se përparimi është i mundur. Ne kemi të dhëna dhe njohuri për të ndërtuar një botë më elastike, gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme ku uria nuk ka strehë - duke përfshirë sisteme më të forta ushqimore dhe investime masive në sigurinë ushqimore dhe përmirësimin e të ushqyerit për të gjithë njerëzit, pavarësisht se ku ata jetojnë,” theksoi në parathënie Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së.

Publikimi i raportit u shoqërua me një komunikatë të lëshuar nga GNAFC.

### Duke parë përpara

Konfliktet, goditjet ekonomike kombëtare dhe globale dhe ekstremet e motit vazhdojnë të ndërthuren gjithnjë e më shumë, duke vepruar me njëri-tjetrin dhe duke krijuar efekte negative spirale në pasigurinë akute ushqimore dhe ushqyerit. Dhe nuk ka asnjë tregues se këta shtytës do të lehtësohen në vitin 2023: ndryshimet klimatike priten të shkaktojnë ekstreme të mëtejshme të motit, ekonomitë globale dhe kombëtare përballen me një



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





**MBËSHTETJE FINANCIARE  
PËR TË GJITHË FERMERËT**

**KREDI E DEDIKUAR  
PËR MBJELLJEN E GRURIT**



## PORTRET

Nga Luftër Xhuveli  
Ish-Ministër i Bujqësisë  
dhe Ushqimit



## Dy fjalë për veprën letrare të Shefqet Mekos

sur me tharmin amerikan dhe natyrën e tij veçanërisht punëtorë, nuk mund të qëndronte me vetëm brenda kufijve të gazetarisë, publicistikës, apo të një tregimtari të thjeshtë. Vullkani që ziente brenda tij, kishte ardhur koha të shpërthente dhe Shefqet Meko, brenda dhjetë viteve, arriti të shkruajë dhe të botojë disa vepra letrare gjurmëlënëse.

Ka disa dekada që shqiptarët po emigrojnë masivisht në vende të tjera. Në këto 33 vite e fundit, nga Shqipëria kanë emigruar për në Evropë, Amerikë e vende të tjera mbi 1.5 milionë shqiptarë. Fatkeqësisht hemorragjia e largimit vazhdon. Në këtë konfigurim demografik, ëndrrat, brengat dhe shpresat e shqiptarëve janë shpërndarë gjithandej. Zor se gjen ndonjë nga ne që të mos i ketë ikur në emigrim ndonji nga të afërmit e tij. Ballsami shërues i ikanakëve tanë, jo rrallëherë shoqërohet me vuajtje dhe zhgënjime. Skenat e dramave të dhimbshme jetësore, zhvillohen tashmë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Amerikë, Gjermani, Itali, Francë, Angli apo në vende të tjera.

Pikërisht, ky realitet i ri përbën shtratin ku po ngjizet, po rritet e lulëzon një letërsi e tipit të ri, pothuajse e munguar deri më sot, letërsia e emigracionit shqiptar, zhanër në të cilën, Shefqet Meko, me botimet e tij, si një përfaqësues i mirëfilltë, po zë një vend nderi.

Shkrimet e Shefqetit janë plot jetë e realizëm, plot me të vërteta që burojnë sa nga realiteti shqiptar, nga përvoja e tij personale si bir i Pretushes

dhe Pogradecit, si student, si gazetar apo aktivist shoqëror, aq dhe nga përvoja në Amerikë. Në librat e Shefqetit rreh pulsi atdhetar i shprehur në krahasimet dhe kontrastet pa fund midis Amerikës dhe Shqipërisë. Në rreshtat e atyre librave, jo vetëm në librin e titulluar "Këtu dhe Atje", pershkruhet psikologjia e emigrantit që edhe pse mund të ketë shumë vite në atë kontinent të largët, e kthen kokën parresh-tur nga Shqipëria dhe fatet e saj.

Në këtë udhëtim nuk janë të pakët edhe ata që të pushtuar nga dilema "të rri apo të mos rri", kanë zgjedhur të rikthehen në vendin ku kanë lërë. Nëpër faqet e librave të Shefqetit, përmes personazheve emigrantë (biseda e Kristo Kovaçit me Xhelo Lakrorin të romani "Saga përtej Atlantikut", faqe 44-45), gjen të latuara dhe të mpleksura me njëra-tjetrën, gëzimet dhe brengat, shpresat dhe zhgënjimet, mëdyshjet dhe konfliktet shpirtërore, sa dëshirën për t'u larguar nga Shqipëria, aq dhe mallin për t'u kthyer sërish në vendin e lindjes, të denja këto për konfliktin shpirtëror të Faustit të Gëtes kur thotë: "Oh dy shpirta kam në kraharuar, por që të dyja mes tyre nuk kanë të shkuar".

Në letërsinë brilante të Shefqet Mekos, të shprehur me një stil origjinal, e cila kulmon në romanin e tij "Saga përtej Atlantikut" dhe në novelën "Viza Amerikane", gjen shpesh alternimin e narracionit me dramën njerëzore, meditimin dhe përsiatjet me hamendësimet dhe fantazinë, pershkrimet për njerëzit, qytetet, natyrën, me

psikoanalizën, kalimin e personazheve nga një gjendje emocionale e gëzuar dhe euforike në zhgënjim dhe dëshpërim, nga evidenti i virtyteve si rasti i Artan Pojanit të novela "Viza Amerikane", te hajduti i identitetit të tij Arshim Gatrani, i cili për të marrë vizë dhe nënshtetësi amerikane, me pafytyrësinë dhe sjelljet kriminale të tij, mendon absurditetet dhe kryen një mijë e një të zeza për interesat e tij të ulëta. Shefqeti në tregimet dhe publicistikën e tij letrare, me një nerv qytetar plot atdhetari, i kundërvihet absurditetet të shumta që po ndodhin në vendin tonë, siç është rasti i betonizimit të skajshëm të Tiranës, i krahurës urbanistike, dëmtimit apo zhdukjes së "simboleve të qytetërimit shqiptar" siç është zhdukja nga sytë e qytetarëve të saj, i kullës së Sahatit e shumë të tjera si këto. "Me dhëmb kjo krahurë" shkruan shkrimtari Shefqet Meko, por siç thotë shkrimtari anglezo-irlandez Oliver Goldsmith (1728-1774) në romanin e tij "The Vicar of Wakefield": "Every absurdity, has a champion to defend it" ("Çdo absurditet e ka një kampion që e mbrohet atë").

Novela "Viza Amerikane" është shkruar me një nivel të lartë artistik. Novela stigmatizon dhe hedh dritë në skutat e errëta të batakçinjve, spekulantëve, hajdutëve dhe njerëzve të degjeneruar, në pislëqet dhe ligësitë e tyre, të cilët pas viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, jo vetëm mbinë si kërpudhat pas shiut, por vazhdojnë edhe sot me një kamuflim të përfeksionuar. Novela përmban në vet-

vete një apel të fortë për luftën kundër korrupsionit, hajdutllëkut dhe burokratizmit, kundër absurditetëve që si rrjeta merimangë kanë mbërthyer shoqërinë shqiptare në të gjitha sferat e saj deri në majë, dhe shtynjë shqiptarët në rrugët e trishta të emigrimit.

Personazhe të tillë si Xhelo Lakrori të "Saga përtej Atlantikut", Artan Pojani të "Viza Amerikane" apo Mitat Smokthina dhe Visho Terfili të novela "Ngjyra e Syve" në librin "Diku puthen retë", e plot të tjerë si këta, janë skalitur me kujdes e mjeshtëri mbresëlënëse. Ato të mbeten në mendje sa që nuk mund të harrosh kollaj as prejardhjen e tyre, as karakterin, as historinë e tyre. Ata të bëjnë që të përjetosh bashkë me ta fatin e tyre.

Më ka ndodhur disa herë, që i tërhequr nga "pompimi" apo zhurma mediatike, si dhe nga njohja personale që kam patur me ndonjë nga autorët e romaneve të sapobotuara, të kem nisur të lexoj romanet e tyre, por me gjithë zellin tim për të lexuar, i cili akoma nuk është fashitur, disa nga këto libra nuk i kam lexuar dot deri në fund, i lodhur e i mërziutur prej prozaizmit të tyre e tejzgjatjeve të tipit hiq e mos këput, i kam lënë ato në mes. Kjo nuk më ka ndodhur me librat e Shefqetit, të cilat karakterizohen nga një tërheqje prej ferromonesh në çdo faqe që lexon.

Në librin me tregime dhe skica letrare "I tillë jam", jepet një tablo e zgjeruar plot realizëm e jetës së njerëzve të thjeshtë, si të ngjarja mbresëlënëse e tregimit "Dasma e

motrës". Në një tregim tjetër, Ai përshkruan tërë ngjyra dhe liston plot dashuri dhe respekt njerëzit e shkolluar apo të ditur të fshatit të tij Pretushë. Në tregimin "Makthi i një burri" jep karakterin fisnik të pedagogut të ditur Aleko Xoxe, të cilin e kemi dashur dhe respektuar të gjithë. Në skicën "Maskarada e tranzicionit", me një nerv qytetar Ai fshikullon vanitetin dhe bëma e klasës së sotme politike në Shqipëri dhe degradimin e skajshëm të saj, të cilës i janë errur sytë për para dhe pushtet, duke shkelur me këmbë interesat e një populli të tërë.

Te romani, novelat dhe tregimet e tij të shumta, Shefqeti ka derdhur talentin e tij, ka pasqyruar shpirtin e tij qytetar të trazuar. Duke u bërë përfaqësues dhe zëdhënës i shpirtit të emigrantit, Shefqet Meko me mjeshtëri të veçantë dhe plot ndjenjë, ka përshkruar me dashuri dhe mall të pashuar, vendin e tij të lindjes, Pretushen, Pogradecin, Liqenin aty pranë, Malin e Thatë përkundruall, jetën e fshatit, duart me kallo të prindërve dhe bashkëfshatarëve të tij, duke i ngritur lapidar punës së ndershme dhe natyrës së bukur shqiptare.

Së fundmi, dëshiroj të theksoj se sot, ne jemi dëshmitarë, se klubit të shkrimtarëve të vërtetë në Shqipëri, i është shtuar edhe një shkrimtar tjetër, i cili akoma nuk e ka thënë të plotë fjalën e tij. Shpresoj dhe uroj se do të kemi rastin të mblidhemi sërish për të promovuar të tjera vepra letrare të shkrimtarit Shefqet Meko.

*Urime Shefqet!*

**Prof. Dr. Luftër Xhuveli**  
**Profesor Emeritus**

Verie Tahiraj është një grua e fortë dhe e vendosur, e cila prej vitesh ka mbajtur familjen në vështirësi ekonomike. Kur iu shfaq mundësia për të siguruar një burim të ardhurash duke u bërë pjesë e zinxhirit të vlerave artizanale, ajo e shfrytëzoi pa hezitim. Dëshira e saj e madhe për të mësuar aftësi të reja dhe për të fituar para nga talentet e saj u ushqye nga një dëshirë e fortë për të arritur ëndrrën e saj hershme: të punonte dhe më në fund të shlyente borxhet e saj.

"Unë udhëtoj dy orë në ditë dhe nuk kam humbur asnjë ditë trajnimit gjatë kursit tre mujor", kujton Tahiraj, e cila banon në periferi të Tiranës, kryeqyteti i Shqipërisë. Ajo jeton në një shtëpi me burrin e saj, dy fëmijët dhe vëhërrit e saj me aftësi të kufizuara, duke mbajtur përgjegjësinë për t'u kujdesur për të gjithë familjen e saj. Tahiraj është një anëtare krenare e një prej grupeve që ka marrë trajnime teknike dhe mbështetje në prodhimin e qeramikës dhe mallrave të tjera artizanale, falë një ndërhyrjeje të "UN Women" që synon fuqizimin ekonomik të grave, financuar nga Bashkimi Evropian. Deri më tani, 25 gra nga njësi administrative Farkë, rreth 7 km larg kryeqytetit, kanë forcuar përfaqësimin e tyre, kanë zgjeruar njohuritë e tyre përmes këtyre mundësive të mësimit dhe shkëmbimit, si dhe kanë

## Nga tradita te fuqizimi - gratë artizane mësojnë aftësi të reja në qendrën e sapokrijuar artizanale në Tiranë

ndërtuar kapacitetet e tyre në mbrojtje të interesave të tyre dhe lehtësimin e dialogut mes grave artizane dhe bizneseve.

Bie në sy që këto gra tani kanë arritur të krijojnë qen-

të OKB-së "BE për Barazinë Gjinore në Shqipëri", zbatuar nga UN Women dhe UNFPA dhe financuar nga Bashkimi Evropian.

"Sot, ne kemi një shtëpi të



drën e tyre të parë artizanale në Farkë, një hapësirë të përbashkët pune që e menaxhojnë dhe operojnë vetë dhe gjithashtu kanë lançuar një markë lokale "Farka Autentike", të cilën e përdorin për të tregtuar të gjitha punimet e tyre artizanale dhe produkte të tjera të punuara sipas traditave të pasura të zonës. Qendra artizanale dhe marka e re u prezantuan zyrtarisht në Mars 2023, në kuadër të Programit të Përbashkët

re të produkteve artizanale vendase në kryeqytet, të mbushur me një grup grash të shkathta dhe pozitive, plot energji dhe dëshirë të fortë për të dhënë më të mirën e tyre", thotë Armida Alikaj nga organizata Investime për Zhvillimin Social (SDI), e cila zbatoi këtë iniciativë të "UN Women", kryesisht për gratë me të ardhura të vogla ose pa të ardhura.

Dhoma Kombëtare e Artizanatit i certifikoi këto gra me

titullin "Asistente Mjeshtre". Kreu i Dhomës, Luan Bregasi, theksoi se edhe në komunitetet më të vogla, talenti dhe pasioni i gruas mund të lulëzojë dhe të përcillet brez pas brezi.

Për disa muaj ata u trajnuan për të zhvilluar aftësitë e tyre, për të përmirësuar së bashku proceset e prodhimit dhe për të zhvilluar produkte të reja krijuese që plotësojnë kërkesat e tregut vendor dhe ndërkombëtar. Ata kanë marrë pjesë në panairë dhe kanë lidhur një kontratë për të prodhuar produkte artizanale për një kompani në Irlandë.

"Bashkëpunimi mes artizanëve vendas dhe tregut ndërkombëtar është një praktikë e re në Shqipëri dhe ne jemi krenarë që jemi pionierët e parë të këtij modeli", thotë Armida Alikaj, Menaxhere e Projektit të SDI.

"UN Women" ka përdorur qasjen e "zinxhirëve të vlerave të ndjeshmërisë gjinore dhe zhvillimit të tregut", për të reduktuar pengesat e veçanta gjinore për pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë ekonomike të grave dhe për të promovuar barazinë midis grave dhe burrave. Falë projektit "BE për Barazinë Gjinore në Shqipëri",

UN Women ka krijuar zinxhirë të shëndoshë vlerash në katër vende të ndryshme në të gjithë vendin, përfshirë Farkën, e cila njihet për traditën e saj shekullore në qeramikë. Sot, gratë artizane në Farkë janë të përfshira në mënyrë aktive në zinxhirin e vlerave artizanale si Punimi i Qeramikës, Përpunimi Artizanal i Ushqimit dhe Punimi Artizanal i Leshit.

Shumica e grave artizane në grup janë pjesë e zinxhirit të vlerës, por ato mbeten kryesisht të padukshme kur përballen me sfida që lidhen me pabarazitë gjinore në biznes apo sfida e përballjes së përgjegjësisë familjare me atë të punës së tyre," shpjegon zonja Alikaj.

Verie Tahiraj është një shembull kryesor i këtyre sfidaeve, duke punuar nga shtëpia për të krijuar produkte qëndisje dhe thurje për shitje të shitësit e mundshëm me pakicë dhe njëkohësisht duke mbajtur mbi supe barrën e rëndësishme të kujdesit për anëtarët e familjes me aftësi të kufizuara dhe kryerjen e përgjegjësisë familjare.

"Ne besojmë fort në fuqinë transformuese të pjesëmarrjes ekonomike të grave dhe mbetemi të përkushtuar për të mbështetur iniciativat që ngre-

në dhe forcojnë gra artizane për të arritur potencialin e tyre të plotë," theksoi përfaqësuesja e UN Women në Shqipëri, Michele Ribotta.

Por angazhimi i këtyre grave për të punuar së bashku dhe për të përfutur nga projekti ka qenë sfidues.

"Bëmë përpjekje për të krijuar hapësira pune në dy vende të ndryshme për të inkurajuar pjesëmarrjen e gjerë nga fshatra të ndryshëm", thotë znj. Alikaj nga SDI, duke kujtuar përpjekjet e kontaktit derë më derë në gjashtë fshatra të njësisë administrative Farkë. Megjithatë, gratë ende përballen me rezistencë dhe duhet të justifikohen sa herë që kanë nevojë për shtëpitë e tyre, për shkak të mentalitetit patriarkal të rrënjësuar thellë.

Znj. Tahiraj, e cila drejton një nga këto vende pune, tregon se gratë duhet të mbyllin dritaret, për të evituar thashethemet dhe bisedat negative për to dhe për qëndrimin e tyre së bashku. Në komunitetin e saj është krejtësisht e papranueshme që një grua të punojë jashtë shtëpie gjithë ditën. Pavarësisht ajo qëndron e vendosur dhe pranon haptazi agjencinë e saj duke thënë: "Unë tani jam mësuar me këtë gjë dhe mund të them se ndihem më mirë. Kjo eksperiencë e re e punës jashtë shtëpisë ka qenë si një terapi për mua."

# MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

### QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË-KRUJË

Toka është mbështetja esenciale e jetës njerëzore, jo vetëm në lidhje me furnizimin me produkte bujqësore dhe blegtorale, por gjithashtu për prodhimin e tekstileve dhe strehim.

Rritja e shpejtë e shkallës së përdorimit të tokës si rezultat i presioneve nga popullata, teknologjitë e përdorura dhe zhvillimi industrial, ka shkaktuar përshtetimin e degradimit të tokës në shumë vende të botës.

Tokat e kripura shtrihen rreth 40.000 ha të lokalizuara në pjesën bregdetare të vendit, nga Xara e Sarandës dhe deri në Velipojë në Shkodër. Në Sarandë tokat e kripura shtrihen në Vrinë, në rrethin e Vlorës shtrihen në Zvërnec, Akërnë, Pishë-Poro dhe Novoselë. Në qarkun Fier këto toka shtrihen në Hoxharë, Topojë, Ndërmenas, Levan, Libofshë, Seman, Seman plazh etj. Në rrethin e Lushnjës shtrihen në Rremas, Bedat, Divjakë, Krutje, Savër, Plug. Në Durrës shtrihen në Qerret, Spital, Spille, Jube, në Krujë, në Adriatik, në Lezhë në Ishull Lezhë dhe Tale, në Shkodër në Velipojë. Në qarkun e Fierit rreth 20.000 ha tokë në zonën perëndimore të qarkut janë me probleme kripëzimi. Mund të përshkruhet si fusha më e sheshtë e vendit me një pjerrësi tepër të vogël drejt detit Adriatik, që varion ndërmjet 0.0 dhe 0.5 %. Pjesa më e madhe e fushës ka një lartësi jo më të madhe se 5 m mbi nivelin e detit, ndërsa pjesa tjetër më në thellësi shkon 8-10 m.

Ka shumë shkaqe të mundshme për degradimin e tokës; përmbajtjet me ujë dhe ngjeshja, erozioni, acidifikimi, kripëzimi dhe sodimi. Të gjithë këto dhe në veçanti kripëzimi dhe sodimi, mund të reduktojnë vlerën e përdorimit të tokës në zonat me fushore të vendit. Dhe tani, më mijëra ha kanë dalë jashtë kultivimit sepse ato janë bërë shumë të kripura dhe si pasojë kanë pësuar një reduktim të thellë dhe ndryshim të kushteve të mjedisit tokësor.

Faktorët e degradimit të tokës janë faktor kimik, fizik, biologjik dhe procese të tjera specifike të cilat ulin pjellorinë e tokës dhe si rezultat struktura e tokës shkatërrohet, lënda organike pakësohet dhe bashkë me të edhe lëndët ushqyese, (azoti, fosfori, potasi, squfri, magnezi dhe sasi më të vogla mikroelementesh). Sasi shumë të mëdha azoti, squfuri, kalciumi dhe magnezi mund të humbasin me anë të shplarjes në kushtet e një mjedisi tokësor të lagët. Në kushtet e një regjimi hidrik dhe ajrore të përkëqësuar, humbjet e azotit rriten së tepërmi në sajë të denitrifikimit biologjik dhe kimik. Oksidet e azotit (NO dhe N<sub>2</sub>O), produkte të denitrifikimit mikrobial largohen nga toka në atmosferë duke u implikuar kështu në ngrohjen

## TOKAT E KRIPURA SHTRIRJA DHE RRUGËT E PËRMIRËSIMIT TË TYRE

globale.

Nëse drenazhimi i brendshëm i profilit të tokës është i pa mjaftueshëm për të kulluar tokën, kripërat e sjella me ujë dhe ujitjes mund të ngrihen në sipërfaqe të tokës si rezultat i normave të larta të avullimit. Ripërdorimi i ujit të drenimit për ujitje përshtet procesin e kripëzimit. Kripëzimi i shtresës aktive të tokës ndodhë gjithashtu si rezultat i kapilaritetit të rritur të profilit të tokës. Kalimi i kripës nga uji nëntokësor si rezultat i difuzionit dhe infiltrimit nga kanalet kulluese në sipërfaqe të tokës krijon kripëzimin e dytë.

Një problem tjetër i lidhur me ujitjen e induktuar është alkaliteti ose sodimi. Sodimi është përçues i natriumit të këmbëshëm. Impakti i saj manifestohet në prishjen e strukturës së tokës. Përdorimi i ujit në zonat më kripëzimi të rritur më shumë se 15% Na të këmbëshëm çon në formimin e tokave alkaline ose sodike, nëpërmjet procesit të hidrolizës. Aplikimi i ujit për ujitje me përmbajtje të lartë bikarbonate të sodiumit ose karbonate sodiumi në toka me përmbajtje të ulët Ca dhe Cl, në këto kushte thërmijet e argjilit thithin kripërat e sodiumit dhe magnezit dhe kështu humbin përshkueshmërinë e tyre duke krijuar kushte të papërshtatshme për difuzionin e ujit dhe O<sub>2</sub> për rrënjët e bimëve dhe mikroorganizmat.

Kripëzimi i tokës përbën rrezikun kryesor të bujqësisë së ujitur. Bujqësia e ujitur në një mjedis të thatë dhe gjysëm të thatë sjell në vetvete rrezikun e degradimit të tokës si rezultat i kripëzimit dhe sodimit. Në zgjerimin e tokave të kripura dhe ato me probleme kripëzimi, mendojmë se kanë ndikuar një sërë faktorësh. Ndër më të rëndësishmit mund të përmendim:

- **Funksionimi jo i mirë i rrjetit kullues** në zonën fushore bregdetare, që ka sjellë ngritjen e nivelit të kripërave në shtresat e sipërme të sipërfaqes së tokës.
- **Përdorimi i ujërave me përmbajtje të lartë kripërash** dhe në shumë raste të pa analizuar më parë.
- **Përdorimi i ujërave të kripura për ujitje**, të marra nga sistemi i kullimit dhe ujërat nëntokësore.
- **Mungesa e kultivimit të tokave për një kohë të gjatë ose abandonimi i tyre** në më shumë se 15 vjet.
- **Menaxhimi jo i mirë i tokave të rrezikuara** nga kripëzimi dhe sodimi (cilësia e ujërave, dinamika e ujërave sipërfaqësore, drenazhimi, shkalla e kultivimit, sistemi i kulturave etj.)
- **Përdorimi pa kriter i plehrave kimike dhe kimikateve të ndryshme** në zona të veçanta me aktivitet intensiv, sidomos në kulturat perimore në serra.
- **Ndikimi i formacioneve tokëformuese të tokës dhe infiltrimet nga ujit të detit dhe**

kënetat me të cilat kufizohen tokat e kësaj zone.

### Disa nga rrugët e përmirësimit e përmirësimit të tokave të kripura

Përcaktimi i masave për shkripëzimin e tokave dhe përmirësimin e tyre mbështetet në shkallën, natyrën dhe tipin e kripëzimit. Treguesit bazë janë përmbajtja e përgjithshme e kripërave, si dhe përmbajtja e klorit dhe natriumit të këmbëshëm.

Përcaktimi i natyrës së kripëzimit mbështetet në vlerën e raportit midis jonëve të klorit dhe sulfateve të shprehura në miliekuivalent. Kur vlera e raportit Cl:SO<sub>4</sub> është më shumë se 5, natyra e kripëzimit është klorur, 1-5 është kloruro-sulfat, 0.2-1 është sulfato-klorur dhe kur vlera është më e vogël se 0.2 natyra e kripëzimit është sulfat. Mbi bazën e këtyre klasifikimeve përcaktohen masat shkripëzuese që duhen zbatuar për një përvetësim të shpejtë të tokave të kripura, proces i cili kalon në dy faza:

#### Faza e parë:

##### Masa hidroteknike:

**Funksionimi i hidrovoreve dhe rrjetit kryesor kullues:** Për këtë është e domosdoshme funksionimi i rregullt gjithëvjetor i hidrovoreve, duke mbajtur nivelin në hyrje të vaskave në kuotat e projektuara. Në mënyrë të veçantë nuk lejohet rritja e nivelit të ujit në kanalet kryesore gjatë verës, pasi bëhet shkak për ngadalsim të procesit të shkripëzimit të tokave dhe në raste të veçanta mund të çojë në rikripëzim të tyre.

**Rrjeti i tretë kullues:** Ndërtohet dhe mirëmbahet sipas parametrave të projektit. Thellësia e tij duhet të jetë jo më pak se 1.8-2.0 m në toka të rënda e të mesme, 1.3-1.5 m në tokat e lehta dhe në tokat ranore 0.8-1.0 m. Ky rrjet është hallka kryesore që ndikon në largimin e kripërave nga ngastra kur mbahet sipas projektit ose në rikripëzim të saj kur nuk pastrohen.

**Rrjeti ujitës:** Në fazën e parë, kur përqendrimi i kripërave është mbi 1% nevojiten sasi të mëdha uji për shpëlarje, gjë që duhet të mbahet parasysh gjatë projektimit të rrjetit ujitës. Për fazat e mëvonëshme të përvetësimit normat e ujitjes duhet të jenë 5000-5500 m<sup>3</sup>/ha në varësi të bimëve që do të mbillen. Kur përqendrimi i kripërave në tokë ulet nën 1 % uji i këtij rrjeti do të përdoret për ujitjen e bimëve që mbillen me kusht që ai si rregull të mos përmbajë sasira kripërash mbi 1 g/litër. Rrjeti ujitës mbahet në gadishmëri për të siguruar ujitje gjithëvjetore. Në tokat e kripura ranore ujitja me shihedhje është e domosdoshme.

**Nivelimi sipërfaqësor:** Është masë që u paraprin punimeve shkripëzuese. Sistemimi bëhet me projekt dhe ruan pjerrësinë natyrale në drejtim të rrjetit të tretë kullues.

#### Shkifrimi në thellësi dhe drenazhimi:

Në tokat e rënda dhe të mesme me përmbajtje kripërash mbi 1% bëhet shkifërimiti në thellësi 70-80cm e largësi përkatësisht 1 dhe 2 m paralel me kanalet e tretë kullues. Në tokat me përmbajtje kripërash nën 1% thellësia e shkifërimitit zvogëlohet duke përdorur shkifërues të thellësive me të vogla (40-50 cm). Në tokat që janë nën kulturë dhe përqindja e kripërave në shtresën 50 cm është nën 0.6 %, kullimi mund të realizohet me drenazh të mbyllur.

**Gipsimi:** Kur natriumi akumulohet në tokë, teknikat e menaxhimit kanë për qëllim uljen e nivelit të natriumit. Gipsi i shtuar në tokë mund të shkaktojë ndryshim të përshkueshmërisë me anë të rritjes të përqendrimit të elektrolitit dhe efekteve të shkëmbimit të kationeve. Sasia e gipsit të nevojshëm për përmirësimin e tokës varet nga sasia e Na të këmbëshëm në profilin e tokës.

Dozat e gipsit sipas përmbajtjes të Na të këmbëshëm në tokë janë si më poshtë:

Niveli i Na të këmbëshëm në mek/100 g tokë të thatë	Sasia e gipsit (CaSO <sub>4</sub> ·2H <sub>2</sub> O) Ton/ha
1	4.25
2	8.40
3	12.75
4	17.00
5	21.25
6	25.50
7	27.75
8	34.00
9	38.25
10	42.50

Sasia e gipsit të nevojshëm mund të përdoret e ndarë në dy vjet. Sasia e çdo viti përdoret në këtë mënyrë: ½ në plugim 21-25 cm dhe pjesa tjetër në diskim ose frezim. Në se do të përdoret e gjithë sasia e gipsit brenda vitit, shpërndarja bëhet si në rastin e vit të parë. Në përcaktimin e sasisë së gipsit që do të përdoret gjatë vitit merret parasysh edhe sasia e ujit që përdoret për shpëlarje si dhe uji i rreshjeve apo i ujitjeve, lidhur kjo me shkallën e tretëshmërisë së gipsit në ujë (2 g/litër). Dy ton /ha gips për tretje kërkojnë 100 mm uji (ujitje apo rreshje). Në këto sasi duhet patur parasysh humbjet nga avullimi. Kështu në se bien 1000 mm rreshje, efektiv për shpëlarje mund të jetë 400-500 mm ose 4000-5000 m<sup>3</sup>/ha. Në këtë rast sigurohet tretja

## KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

# MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË-KRUJË

(Vijon nga faqja 11)

e 8 ton/ha gips. Krahas reshjeve në tretjen e gipsit ndikojnë edhe shpëlarjet me ujë dhe ujitjet.

**Plugimi i tokës:** Në tokat agjilore të rënda në proces shkripëzimi dhe përmbajtje kripe 0.6-1.0 %, çdo vit bëhet plugimi 36-40 cm dhe diskim sipas nevojës. Në tokat nën 0.6% kripë të cilat janë nën kulturë bëhet plugimi 26-30 cm dhe diskim sipas nevojës. Toka punohet në sistem kurriz të lehtë.

**Vijat kulluese:** Vijat kulluese, si element i rëndësishëm për shkripëzimin e tokave shumë të rënda në fazën e parë hapen çdo vit në thellësi 70-80 cm e largësi sa gjysma e gjerësisë së lehtë të piketimit.

**Shpëlarja me ujë:** Përdoret si masë plotësuese krahas shpëlarjes nga rreshjet e shiut për largimin e kripërave në tokat me përbërje mekanike të rëndë dhe të mesme që përmbajnë mbi 1% kripëra. Kushte për shpëlarjen me ujë është marrja e masave komplekse të njëkohëshme, si plugimi, shkrifrimi i thellë, hapja e vijave të thella kulluese, shpërndarja e

### TOKAT E KRIPURA SHTRIRJA DHE RRUGËT E PËRMIRËSIMIT TË TYRE

gipsit, nivelimi sipërfaqësor dhe ndërtimi i oxhaqeve me sipërfaqe sa ajo ndërmjet dy vijave kulluese me ledhe 60x30 cm. Nuk duhet të lejohet që uji të rrjedhë nga bankinat në vijat kulluese. Norma e ujit për shpëlarje jepet në varësi të përbërjes mekanike dhe shkallës së kripëzimit të tokës. Në tokat me përbërje mekanike të mesme gjatë një sezoni shpëlarës, sipas shkallës së kripëzimit, përdoren nga 4000-6000 m<sup>3</sup>/ha.

Para fillimit të shpëlarjes toka e pluguar më parë thahet për disa ditë, pastaj mbyllet kokat e vijave kulluese dhe oxhaqet mbushen me ujë. Pas 5-8 orësh, kur niveli i ujit në oxhak arrin 10-15 cm, hapen kokat e vijave kulluese dhe uji lihet që të filtrojë dhe të largohet. Më pas futet dora e dytë e ujit për shpëlarje me normë 1500-2000 m<sup>3</sup>/ha dhe lihet të filtrohet në tokë. Në rast se uji për 4-5 ditë nuk filtron, largohet nga ngastra duke hapur presa në ledhet e oxhaqeve. Në këtë mënyrë vazhdohet deri në dhënien e plotë të

normës së ujit për shpëlarje. Pas përfundimit të shpëlarjes, menjëherë sa të lejojnë kushtet, bëhet shkrifrimi sipërfaqësor i tokës për të penguar ngritjen kapilare të kripërave.

Shpëlarja e një ngastre në varësi të përmbajtjes së kripërave zgjat nga 1-2 vjet derisa përmbajtja e kripës të ulet nën 1%. Para dhe pas shpëlarjes ndiqet dinamika e Na të këmblyshëm.

**Faza e dytë:** Kjo fazë fillon kur tokat pranojnë mbirjen dhe zhvillimin e bimëve. Zgjedhja e bimëve që mbillen në këto toka bëhet mbi bazën e përmbajtjes së kripërave dhe tolerancën ndaj kripëzimit.

Kur toka përmban 0.6-1.0% kripë mbillen bimë tolerante ndaj kripëzimit si festuk, lolium, elb, grurë, tërshërë, sorgum, panxhar, etj. Kusht i domosdoshëm për të siguruar prodhimin e dëshiruar nga bimët është sigurimi i mbirjeve brenda 15 shtatorit, për mbjelljet e foragjereve të vjeshtës dhe brenda 20 tetorit për grurin,

elbin, tërshërën, etj. Për të gjithë bimët duhet siguruar ujë gjatë gjithë periudhës vegetative.

Në tokat që përmbajnë më pak se 0.6% kripë bëhet punë më intensive për shëndoshjen biologjike me pleh organik duke përdorur 300-400 kv/ha. Veç përdorimit të plehut organik planifikohet edhe mbjellja e kulturave të dyta për plehërim të gjelbër. Në këtë rast bimët më të përshtatshme janë sezbanja, sorgumi, trifili, tërshëra, batha, soja, etj.

Në tokat me përmbajtje të kripës mbi 1% duhet të shfrytëzohen me sera për kultivimin e perimeve, hardhisë, luleshtrydheve, luleve, etj. Në këtë rast duhet të sigurohet ujë për ujitje me pika dhe drenazhimi i tokave që përdoren për këtë qëllim.

Është e rëndësishme të theksohet se tokat me faktor kufizues të prodhimit përbëjnë bazat e aktivitetit ekonomik në disa zona bujqësore të vendit. Për këtë arsye problemi i trajtimit të këtyre tokave bujqësore apo kthimi në ekosisteme natyrore të qëndrueshme përbën një problem aktual. Kjo bëhet me imperative, si rezultat i urbanizimit të pa kontrolluar e tokave më të mira rreth qyteteve.

Përgatiti: Msc. Florjana Çela, Dr. Shpëtim Tafaj

**Drejtorja e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave;**  
